



# VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR.2(428)

SHKURT 2024

ÇMIMI: 30 LEKË



Drejtor: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA ; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI & BASHKIM HISARI ; website: www.VETERANIOBVL.ORG

## SPECIALE

**GJENERAL NEXHIP VINÇANI DHE BRIGADA QË S'U BË "HERO I POPULLIT"**



**NGA KOZMA GJINI**

**FAQE 4-5**

## 82 VJETORI I LINDJES

**ALI DEMUSHI, PROFILI I KOLONELIT 82 VJEÇAR, KRYETAR I OBVL SHKODËR**



**Halil RAMA – Mjeshtër i Madh**

**FAQE 8**

## HISTORIA

**QAZIM LIKA, BASHKËLUFTËTAR I ISMAIL QEMALIT, HASAN PRISHTINËS, ELEZ ISUFIT E ISA BOLETINIT**



**Nga Beqir SHEHU**

**FAQE 10**

*Shqipëria është i vetmi vend në Evropën e pushtuar nga nazifashistët që realizoi çlirimin e plotë krejtësisht me forcat e veta*

# 2024 – VITI I 80 VJETORIT TË ÇLIRIMIT TË ATDHEUT

## PËRKUJTIMORE

**4 shkurt 1944, një natë masakrash në Tiranë**

Sipas shkrimtarit dhe gazetarit disident Mustafa Greblleshi, dëshmitar okular, i planifikuar për t'u pushkatuar

**Pregatiti: Sakip CAMI**

**FAQEN 7**



*Shqipëria nxori në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare rreth 70.000 luftëtarë të përfshirë në 24 brigada, 8 divizione dhe 3 korparmata. Konferenca historike e Bujanit i dha një zhvillim të madh Lëvizjes NÇ edhe në Kosovë ku u krijuan 9 brigada partizane dhe rreth 53.000 luftëtarë. Në luftime e operacione të ndryshme në Shqipëri u vranë 28.000 dëshmorë, krahas rreth 20.000 qytetarëve të masakruar, vranë e gjymtuar nga pushtuesit fashistë e nazistë*

**FAQE 3**

## SUPLEMENTI LETRAT



**POEMA "ROMANCA E SKËNDERBEUT"**

**Shkruar nga David Herman Bernstein**

**FAQE 15**

**PANO HALLKO, libër për gjenezën e gjeopolitikës ballkanike**

**Nga Shaban Murati, "Mjeshtër i Madh" në diplomaci**

**FAQE 12**

## AKTUALITET

**INAUGUROHET NJËSIA USHTARAKE E SIGURISË KIBERNETIKE**

**FAQE 9**

**80-VJET - KONFERENCA E BUJANIT**

**IDEALET KOMBËTARE QË NUK U SHUANË KURRË**

**Nga Bashkim Hisari**

**FAQE 6**

## PROFILE

**DY GRA DËSHMORE LABE TË PUSHKATUARA NGA FASHISTËT**

**Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI**

**FAQE 13**

## ESSE

**LETRA E SKËNDER PEPIUT PËR PRINDËRIT**

**Neki ÇAKO**

**FAQE 11**

## VEPRIMTARI

**MADHËSHTIA E PUKËS NË 80-VJETORIN E ÇLIRIMIT TË ATDHEUT**

**OBVL dhe Org. Dëshmorëve kanë programuar një varg aktivitesh përkujtimore dhe promovimesh**

**FAQE 7**

## ANALIZA

**FIGURA MADHORE E ALI PASHË TEPELENËS NË STUDIMET E AKADEMIKUT IRAKLI KOÇOLLARI**

**SHPENDI TOPOLLAJ**

**FAQE 14**

## OPINION

Gjeneral @ Piro AHMETAJ

Në kapacitetin e ekspertit për Sigurinë Kombëtare, Rajonin dhe NATO-s, gjatë 2023, kam ndjekur me vëmendje të shtuar: “dhjetra konferenca të Këshillit të Atlantikut; Institutit të Luftës si dhe kam ndarë opinionet me kolegë në Washington, Bruksel, Londër, Berlin, Samitin e NATO-s, Vilnius, etj. Patjetër, më duhet të falënderoj median (në RSh, Kosovë dhe jashtë vendit) për publikimin gjerësisht të disa 10-ra vlerësimeve.

Për ta nisur këtë vit, në vijim do gjeni një përmbledhje mbi zhvillimet me peshë globale dhe rajonale gjatë 2023 si dhe pritshmëritë për 2024, të fokusuar në gjetje dhe rekomandime strategjike për Tiranën dhe Prishtinën Zyrtare:

Paraprakisht, si referencë-shtyese po citoj “Financial Times”, ç’ka për publikun ballkanik mund të tingëllojë hiperbolike: “12 muajt që lamë, kanë qënë nga më intensivët, për luftën në Ukrainë, Palestinë, etj, por dhe kofoninë mbi demokracinë që bota ka parë që kur ideja u krijua para 2500 vitesh”.

Besoje që ta mirëkuptojmë që as miku ynë/im (AC), Fred Kempe, as Financial Times, as Foreign Policy, nuk u referohen, vetëm Kinës, Rusisë, Iranit, as specifikisht Ballkanit, por sfidës globale me: “një listë të shteteve diktatoriale si dhe vendeve me qeverisje autokratike”.

Si referencë shtesë, gjeopolitikanët sjellin në vëmendje se 70 vende, 8 nga 10 më të populluarat (përfshi SHBA); pra rreth 2 miliardë, ose 1/2 e popullsisë me të drejtë vote; që përfaqëson 60 % të prodhimit bruto të globit do të votojnë në 2024. Kjo mund të tingëllojë për tu festuar, por ekspertët parashikojnë “një rrezik të shtuar për standartet e demokracisë”, pasi këto zgjedhje zhvillohen në një kohë kur shtetet e dështuara, korrupsioni shtetëror dhe inteligjenca artificiale ofrojnë mundësi efektive që: “t’i tërheqin këto vende drejt autoritarizmit”.


Për më konkretisht po ju referohem ngjarjeve gjeopolitike që kanë dominuar 2023, si dhe respektivisht pritshmëritë për vitin në vijim:

Së pari. Rusia-Putiniste, nuk e pushtoi dot (shpejt) as me lule dhe valle për dy muaj si dhe as me tanke, raketa dhe bajoneta as për 2 vjet Ukrainën. Por mbas 680 ditë/netë luftime po zvarritet si terroristët e Hamasit në tunelet dhe llogoret e Zaporizhias, Oblastes, Bakhmutit, Khersonit, etj, duke lënë në fushëbetetë mbi 300 mijë të vrarë, rreth 8 trilion € (ose 4 vite GDP neto të Rusisë; 2022 = 17 trilion); ka humbur me turp iniciativën strategjike të luftës si dhe betejën për të sfiduar rendin e sigurisë globale, kohezionin vlerat dhe fuqinë ushtarake të aleancës trans-atlantike.

Kështu nuk ka mbetur asnjë dilemë, as për mendjet Staliniste, përfshi në Beograd dhe jo vetëm, që Rusia-Putiniste, gjendet sot më e izoluar dhe më e diskretuar se asnjëherë më parë në historinë e saj.

Nga 195 (përfshi Kosovën) vetëm 5 shtete (Koreja e Kim-Jong-ut, Irani dhe 3 shtete terroriste të Afrikës) e

# Bota në luftë për paqe dhe vlerat demokratike



njohën në këtë aventurë neo-naziste. Po për shkak të kësaj lufte rrezikon potencialisht përjashtimin nga 5-shja vendimarrëse e Këshillit të Sigurimit/OKB si dhe nga Gjykata Ndërkombëtare është lëshuar “urdhër arresti për krime lufte” ndaj Putinit si dhe për listën e ngushtë të Gjeneralëve zullumqare rreth tij.

Ndërsa Ukrahina martire e ka mbyllur 2023, me përparime konstante të kundëroffensivës (mbase jo entuziaste). Për vitin 2024 mbetet me e vendosur se kurrë për të mbrojtur territoret e marra, kohezionin e kombit dhe inisjativën strategjike deri në ri-marrjen edhe të Krimesë së statusquosë se para Marrëveshjes së dështuar në 2014.

Prandaj, me kolegët në Ëashington, Bruksel, Londër etj besojmë fort që pavarësisht makinerisë së propagandës Putiniste, viti 2024 do jetë jo vetëm viti i humbjes turpëruese që e pret Rusinë-Putiniste në Ukrainë, por dhe i gjynjësimit ndaj vendosmërisë dhe mbështetjes ushtarake, nga USA/NATO/UK/BE (paketa 100 miliard € për armatime moderne).

Së dyti. Masakra e Hamasit ndaj 1200 civilëve Izraelit dhe 41 vende të botës më 7 Tetor 2023, ndërsa terroristët si monstra cirreshin: “Allahu akbar, pasi masakruan qytetarë në festë publike; u prisnin kokat femijëve; mernin zvarrë pengje gjyshër, gra dhe vajza, përdorin si barrikada (ç) njerëzore bashkëqytetarë nga Rripi i Gazës”, kurrësesi nuk kanë të përbashkët me vlerat e fesë Islame.

Kështu, jo vetëm izraeli u kërcënua por dhe sistemi global i sigurisë u vunë në sprovë. Prandaj e përsëris, se përtej rrethanave të Izraelit për mbijetesë “ushtrimi i të drejtës sovraane së hakmarrjes shembullore ndaj terroristëve”, mbetet edhe misioni i përbotshëm. Në të kundërt, A nuk do të krijohej një precedent fatal për sistemin e sigurisë dhe vlerat e qytetërim-it? E thënë ndryshe: “nëse Izraeli u dorëzohej/t terroristëve, në një akt të ngjashëm edhe Berlini, Londra, Parisi dhe çdo vend demokratik, çfarë

pasoje do të ketë mbi paqen dhe shoqërinë njerëzore”?!

Nga ana tjetër, risjellim në vëmendje se riciklimi i konfliktit të përgjakshëm në Lindjen e Mesme, ishte gjellë e helmatisur e Kremlinit, por duhet ta pranojmë që arriti që nëpërmjet grupeve terroriste të prodhonte disa pikëpyetje afatshkurtra mbi kundëroffensivën e Ukrainës.

Gjithsesi historia e pas-konfliktëve të përgjakshme na mëson se rruga drejt paqes kërkon kompromise të mëdha. Pra vetë-përmbajtje, respektimin e konventave ndërkombëtare; armë me precizion të lartë (por të pamëshirshme kundër terroristëve); korridore humanitare për të shmangur në maksimumin e mundshëm viktimat e pafajshme (edhe pse 100 % është misioni i pamundur) si dhe paketë me masa të mirëbesimit reciprok.

Nga ana tjetër, më e pakta i gjej mjerane dhe djallëzore kur “internacionalist mëndjendryshkur” venë shenjën e barazisë mes Terroristeve dhe Izraelit (!) apo për më keq edhe Kosovës (!), duke i risjell opinionit oshilacionet marksiste të Enver Hoxhës: “Izraeli një kobure në duart e SHBA/UK..; shtet i krijuar nga imperializmi dhe sionizmi reaksionar”. Thënë këtë, të dy shtetet sovraane (RSh dhe Kosovës) të një Kombi të vetëm, nuk kanë opion të dytë, përveçse në luftën kundër terrorozmit t’i bashkohet pa asnjë hezitim “flamurit të solidaritetit të mbarë botës së qytetëruar” duke dënuar frymëzuesit politik dhe autorët e masakrave kriminale të Hamasit, Putinit dhe si të tillët kudo.

Së treti. Kina gjatë vitit 2023! Pjella e makinerisë së krimit (KGB), Putini dhe Diplomatat/Gjeneralët e “gjunjësuar” të Kremlinit, as e kishin menduar që: “kur vjen fjala për interesat gjeopolitike Kina nuk mund të jetë aleate e natyrshme me Rusinë në luftën kundër USA dhe BE”!

Për më tepër është fakt, se që në fillim të kësaj ndërmarrje kriminale (ndaj Ukrainës) si dhe në 2 vjet lufte Rusia ka marrë refuzimin e Pekinit,

që nuk i ka dhënë as mbështetje ushtarake, por e ka paralajmëruar Moskën për mos-vendosjen e armëve bërthamore në Bjellorusi, etj!

Kina e ka nisur 2024 me një intesitet historik bashkëpunimi me SHBA, përfshi edhe takime biletarale ushtarake, vetëm para disa ditësh. Kështu Rusia edhe për 2024 do të mbetet e pashpresë për të tërhequr Pekinin në këtë aventurë gjeostrategjike për hapjen e një fronti të ri lufte ndoshta jo vetëm ndaj Taivanit.

Së katërti. Barometri i sigurisë në Ballkanin Perëndimor gjatë 2023 mbeti i ndërthurur me luftën në Ukrainë. Ndërsa Rusia-Putiniste keq-dështoi për të ndezur fitilat e luftës duke frymëzuar grupet kriminale në Bosnjë -Hercegovinë; me bojkotimin nga lista Serbe të institucioneve dhe mbështetjen e barikadave të krimit të organizuar në veri. Kaloji çdo kufi me vrasjen në krye të detyrës të dëshmorit Afrim Bunjaku; u vetë-demaskua me riciklimin e kërcënimit ushtarak ndaj territorit të Kosovës dhe prezencës së NATO-s.

Nga ana tjetër, duhet theksuar se edhe për shkak të peshës së diskreditimit gjeopolitik që po përballlet Rusia-Putiniste mbas ndërmarjes neo-Naziste ndaj sovranitetit të Ukrainës, përfshirja në një front të ri lufte në Ballkan (pra në Europë, jo në Afrikë...) do të ishte një aventurë vetëvrasëse. Kjo pasi në këtë rast, kurrsesi nuk do tolerohej dhe jam i bindur që do të ndëshkohej në mënyrë shembullore (shumë më ashpër se në 1999) nga fuqia ushtarake e Aleancës së Atlantikut të Veriut (NATO/USA).

Për 2024, shumë zhgënjyese që e nisi 2024 duke shtuar në buxhetin e mbrojtjes edhe 740 milion € shpenzime për armatime moderne, theksojmë (jo mbrojtëse) si dhe frymëzimin e bandave mercenare nga oshilacionet e Ministrisë të Millosheviçit dhe Rusia-Putiniste.

Thënë këtë, i ri-kujtojmë z. Vuçiq dhe Gjeneralëve të Tij se, Serbia nuk ka gjithsësi fuqi të përballet ushtarakisht as me NATO-n, por as me vendet e Rajonit, edhe nëse nuk ato do ishin anëtare të NATO-s. Thënë këtë kujtojmë që Kroacia, Sllovenia, etj e kanë mundur makinerinë e përgjakshme të Millosheviçit mbas viteve 1990, ndërsa aktualisht kanë zhvilluar kapacitete për ta përballuar dhe mposhtur Beogradin goftë më vite apo goftë të mbështetur nga Moska. Nga ana tjetër, Serbia jo vetëm nuk është e kërcënua nga askush, por askënd nuk tremb dot më, përveçse minon interesat dhe axhendën e integritetit të vetëvetes/Serbisë.

Gjithësesi shpresoj/a që e gjithë kjo marrëzi t’u shërbejë elitave mëndjehapura, në Beograd si “sirena alarmi” për të punuar kundër rikthimit të errësira e urretjes dhe gjakëderdhjes shekullore mes popu-

(Vijon në faqen 3)

## JUBILEU

Shqipëria është i vetmi vend në Evropën e pushtuar nga nazifashistët që realizoi çlirimin e plotë krejtësisht me forcat e veta

# 2024 – VITI I 80 VJETORIT TË ÇLIRIMIT TË ATDHEUT

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇI (OBVL) sjell në vëmendjen e opinionit publik dhe në mënyrë të veçantë, në vëmendjen qeverisë së Republikës së Shqipërisë faktin që viti 2024 është viti i 80-vjetorit të çlirimit të atdheut nga pushtuesit nazifashistë dhe bashkëpunëtorët e tyre vendas. Në këtë kuadër, ashtu si në përvjetorët tjerë jubilarë është domosdoshmëri krijimi i një komisioni të posaçëm shtetëror gjithëpërfshirës. OBVL kërkon që ky komision të jetë gjithëpërfshirës në dimensionet e vlerave që mbart dhe sjell 80-vjetori i çlirimit të atdheut, me qëllim që programimi i çdo detaji dhe festimi i këtij jubileu të jetë i denjë për këtë ngjarje të madhe, të jetë i denjë për të nderuar sakrificën sublime, gjakun e dëshmorëve, heroizmin e luftës partizane, e cila ishte dhe mbetet lufta më e madhe patriotike që ka zhvilluar populli shqiptar. Kjo sipas kryetarit të OBVL, kolonel Sotir Budina, për faktin se nderimi i 80-vjetorit të çlirimit të atdheut është padyshim një meritë për Shqipërinë evropiane, sepse në themel të Evropës së Bashkuar qëndrojnë vlerat e Luftës së Dytë Botërore. Në mbledhjen e saj të pare të këtij viti, Kryesia e OBVL-së konkludoi se një çështje e veçantë që duhet të meritojë vëmendjen e qeverisë qëndrore dhe autoriteteve lokale të qytezave e bashkive, duhet të jetë rikonstruktimi i varrezave të dëshmorëve në të gjitha rrethet e vendit dhe gjithashtu rikonstruktimi i monumenteve të luftës antifashiste nacionale çlirimtare. Vëmendje të veçantë meriton përkujtimi i ngjarjeve që kanë shënuar dhe kanë bërë epokë aq më tepër po të kemi parasysh që Lufta Nacionalçlirimtare e renditi Shqipërinë në krahun e koalicionit të madh antifashist botëror.

Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar është epikeja më e madhe dhe më e lavdishme e popullit shqiptar gjatë historisë së tij për çlirimin kombëtar dhe shoqëror, luftë çlirimtare demokratike, antifashiste që u shndërrua në revolucion popullor nëpërmjet kryengritjes së armatosur, pjesë përbërëse e Luftës së Dytë Botërore Antifashiste. Ajo filloi me qëndresën popullore kundër agresionit fashist të 7

prillit 1939 dhe përfundoi me çlirimin e plotë të Shqipërisë më 29 nëntor 1944.

Gjatë Luftës ANÇ populli shqiptar luftoi e fitoi kundër dy pushtuesve të huaj, Italisë fashiste dhe Gjermanisë naziste që pushtuan vendin njëra pas tjetrës si dhe kundër qeverive kuislinge dhe reaksionit të brendshëm e forcave të armatosura të tyre. Një rol shumë të rëndësishëm për bashkimin e popullit shqiptar në luftën çlirimtare luajti Konferenca e Pezës që u mbajt në shtator 1942, e cila krijoi Frontin NÇÇI. Forcat kryesore lëvizëse të luftës ishin klasa punëtore, e cila luajti rolin udhëheqës në të dhe fshatarësia punonjëse që mba-

ndjeshme në njerëz e teknikë luftarake. U vranë, u plagosën e u ztmë robër mbi 70 mijë armiq. Ato në një varg luftërash e operacionesh mësymëse i shkëputën armikut krahina e zona të tëra që i çliruan përfundimisht ose përkohësisht dhe, në momentin e përshtatshëm nën drejtimin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë NÇ ndërmorën mësymje të një shkalle të gjerë për çlirimin e Shqipërisë së Jugut, të Shqipërisë së Mesme e të Veriut, të gjithë territorit të atdheut tonë.

Armiqtë fashistë i shkaktuan Shqipërisë dhe popullit shqiptar dëme e rrënim të shumta. Shqipëria zë një nga vendet e para për humbje në njerëz

• *Shqipëria nxori në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare rreth 70.000 luftëtarë të përfshirë në 24 brigada, 8 divizione dhe 3 korparmata. Konferenca historike e Bujanit i dha një zhvillim të madh Lëvizjes NÇ edhe në Kosovë ku u krijuan 9 brigada partizane dhe rreth 53.000 luftëtarë. Në luftime e operacione të ndryshme në Shqipëri u vranë 28.000 dëshmorë, krahas rreth 20.000 qytetarëve të masakruar, vranë e gjymtuar nga pushtuesit fashistë e nazistë*



jti mbi shpatullat e saj barrën kryesore të luftës. Me krijimin e Ushtrisë NÇ lufta e popullit shqiptar kundër pushtuesve të huaj e tradhtarëve të vendit u shndërrua në kryengritje të përgjithshme të armatosur. Njësitë dhe repartet e Ushtrisë NÇSH gozhduan në luftë më se 15 divizione italiane e gjermane, përballuan me vetmohim e heroizëm të rrallë, në kushte të pabarabarta, operacionet e veprimet luftarake të tyre, ndër të edhe dy mësymjet e përgjithshme gjermano-balistike të dimrit 1943-1944 e të verës 1944, dhe u shkaktuan atyre humbje të

dhe sidomos në të mira materiale gjatë Luftës II Botërore. Në shkallë ndërkombëtare Lufta Nacional-Çlirimtare e popullit shqiptar ishte pjesë përbërëse e luftës botërore antifashiste. Me luftën e vet heroike populli ynë i tregoi botës se Shqipëria e vërtetë nuk ishte ajo që një grusht tradhtarësh e kishin shpallur "aleate të Boshtit", por ajo që populli kryengritës, me Partinë Komuniste në krye, e kishte vënë veten në radhët e pjesëtarëve më aktivë të popujve dhe shteteve të koalicionit të madh antifashist. Populli kryengritës shqiptar dër-

goi edhe përtej kufijve shtetërorë mjaft luftëtarë të Ushtrisë së tij Nacional-Çlirimtare, të cilët luftuan me vetëmohim për çlirimin e popujve të Jugosllavisë dhe të vëllezërve shqiptarë të Kosovës.

Shqipëria nxori në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare rreth 70.000 luftëtarë të përfshirë në 24 brigada, 8 divizione dhe 3 korparmata. Konferenca historike e Bujanit i dha një zhvillim të madh Lëvizjes NÇ edhe në Kosovë ku u krijuan 9 brigada partizane dhe rreth 53.000 luftëtarë. Në luftime e operacione të ndryshme në Shqipëri u vranë 28.000 dëshmorë, krahas rreth 20.000 qytetarëve të masakruar, vranë e gjymtuar nga pushtuesit fashistë e nazistë.

Pikërisht madhështia e kësaj lufte duhet përkujtuar me madhësi në këtë vit jubilar të 80-vjetorit të çlirimit të atdheut nga pushtuesit nazifashistë dhe tradhtarët e vendit.

Në këtë mbledhje, anëtarët e Kryesisë së OBVL kërkuar gjithashtu mbështetje për vlerësimin e figures së gjeneral Rahman Parllakut në 105-vjetorin e ditëlindjes së tij. Shqipëria evropiane, Shqipëria e sotme është padyshim ëndrra e dëshmorëve të Luftës Nacionalçlirimtare, por që kjo ëndërr të jetë e realizuar në tërë dimensionin e saj qytetar dhe evropian duhet që këtë vit, pra vitin 2024, ta shndërrojë në vitin e 80-vjetorit të çlirimit të atdheut, duke përmbushur të gjitha detyrimet që kemi ndaj qytetarëve shqiptarë.

## Bota në luftë për paqe dhe vlerat demokratike

(Vijon nga faqja 2)

jve të rajonit.

Thënë këtë duhet që ende të besojmë se jo LUFTA por mirëbesimi, PAQJA dhe axhenda e integritetit në NATO/BE mbeten misioni i vetëm i ardhmërisë së qytetarëve të Kosovës, Serbisë dhe të gjitha vendeve të Ballkanit.

Në shtesë, ritheksoj edhe njëherë se: "humbja e luftës, kolapsi ekonomik dhe diskreditimi ndërkombëtar, përfshi në Ballkan që e pret Rusinë-Putiniste mbas Ukrainës; për pasojë edhe dhe Serbinë, mbetet një

rrethanë (por jo dhuratë) e favorshme gjeopolitike në dobi të faktorizimit të RSh në tavolinat e vendimmarrjeve të mëdha, si dhe për të mbrojtur dhe zhvilluar interesat mbarëkombëtare në Rajon, Mesdhe, etj!"

Gjithashtu e çmoj në kohën e duhur, t'i rikëshilloj faktorët në Tiranë dhe Prishtinë: "të përulen në gjunjë para historisë së përgjakshme dhe përgjegjësive shtetërore" për ti dhënë jetë "Patformës 2Shtete sovranë 1Komb i vetëm", duke konfirmuar në Washington, Bruksel, etj se "edhe pse e vonuar" kjo qasje nuk kërcënon asnjë, përfshi Serbinë, përkundrazi do të kontribuojë si bal-

ancë strategjike për paqen afatgjatë dhe axhendën e Integritetit Euratlantik vendeve dhe popujve të rajonit".

Me këtë rast, rikonfirmoj se, mbetem edhe më i përkushtuar për të kontribuar me përulesin në mbrojtjen dhe zhvillimin e interesave kombëtare si dhe për forcimin e partneritetit strategjik me USA/NATO-n.

**Ekspert për SK, Rajonin dhe NATO-n,  
Zv/President i Këshillit të Atlantikut; & ish:  
Këshilltar i Presidentit të RSh;  
Zv/ShShPFA,  
Përfaqësues Ushtarak në SHAPE/NATO.**

## SPECIALE

Me rastin e 80-vjetorit të krijimit të Brig. IV -S

# GJENERAL NEXHIP VINÇANI DHE BRIGADA QË S'U BË "HERO I POPULLIT"

## NGA KOZMA GJINI

"Do të luftoj për çlirimin e atdheut deri në pikën e fundit të gjakut. Për atë do të fal çdo gjë që posedoj, madje edhe jetën." Nexhip Vinçani.

... Këto ishin fjalët e betimit të luftëtarit të lirisë, trimit të pashoq, patriotit të flaktë të LANC, numri 1 i drejtuesve politikë e ushtarakë të zonës së Korçës, strategu i rrallë i taktikave të rrufeshme sulmuese kundër pushtuesve, flamurtar i sprovuar për çlirim, komandantit legjendar të Brigadës së IV-t Sulmuese, gjeneral Nexhip Vinçani, kur zëri i Atdheut ushtonte për liri a vdekje. Për prejardhjen e Vinçanëve po mjaftohemi vetëm me 4 vargje që i ka ngritur populli dhe gjithçka tjetër është e tepërt.

...Po na ujen kjo Rrëza, me flamur në ballë,  
Grekun nuk e duam, jemi shqipëtarë.

Në na pyetshin shokët: kë kini të parë?

Vet e kemi zgjedhur, Kahreman Vinçanë...!

Fisit dhe familjes së Vinçanëve iu vu një kurorë e artë me jetën heroike të Nexhip Vinçanit.


Jeta e rinisë së Nexhipit u mëkua me aromën e patriotizmit, të ndjeshmërisë e të dashurisë për atdheun, krenarisë për origjinën familjare, për vendlindjen, për njerëzit dhe tokën e tij së cilës ai i falë jetën. Arsimin e mesëm e mori në: Korçë, Tiranë e Shkodër, ku u njoh me moshatarë që ndikuan në formimin e tij si: P.Xhuvani, L.Angoni, R.Çollaku, S.Çaçin, P.Lena, H.Papa, Xh.Punavia, V.Kushi, H.Dushi, N.Rushiti, E.Durakun etj.

Më tej, dërgohet për studime në Fakultetin e Drejtësisë në Romë. Këtu, djemtë tanë (1939-41), formuan bërthamën e celulës së studentëve me: sekretar, T.Skëndi dhe N.Vinçani, P.Xhuvani, V.Nathanaili, F.Babani, F.Stamo, N.Resnja, B.Shtylla, V.Dushku e A.Mano, anëtarë.

Për atë periudhë, Nexhipi ka shkruar: "...çdonjëri prej nesh kishte në lidhje disa simpatizantë, shumica e të cilëve thjeshtë për ide antifashiste ncl. Në Romë, por edhe në qytete të tjera të Italisë, kishte shumë shqiptarë në shkollat e kurse të ndryshme për oficerë, karabinierë, roje finance, por edhe shqiptarë të rinj që kryenin shërbimin ushtarak, me të cilët isha ngarkuar kryesisht për të punuar unë..."

Nexhipi ishte njëri nga organizatorët e demonstratës. Djemtë marshuan me flamurin kombëtar dhe karabinieria e arrestoi, bashkë me P. Xhuvanin. Si rrjedhojë e kësaj, i ndërpret studimet dhe kthehet në atdhe, më 28.11.1941.

"Që në ditët e para të dhjetorit 1941, iu përkushtova plotësisht detyrave që lidheshin me LANC. Fill-ova jetën e Partisë në Celulën nr.7 në Korçë, në të cilën bënin jetën e partisë edhe Ymer Dishnica, Dhori Samsuri, Pëllumb Dishnica etj." Ai u bë shtylla e autoritetit të Vinçanëve dhe në bashkëpunim me Ymer Dishnicën e shokët e shkollës së mesme, punuan me të rinjtë për përhapien e ideve patriotike, të bindur se e vetmja rrugë për çlirimin e vendit ishte lufta. Ai u ngarkua nga Komiteti Qarkor që t'ju drejtohej të rinjve me një fjalim, ku u bëri thirrje për të mbushur radhët partizane, thirrje që gjeti gadishmëri të plotë. Në zonën Gorë-Opar etj, u formuan organizatat e Rinisë Antifashiste, çetat e njësitit e armatosura. Vëllezërit "Vinçani" u angazhuan me gjithë shpirt në luftë për liri. Nexhipin e caktojnë komandant i Shtabit partizan



të Qarkut të Korçës.

"Në mbrëmjen e datës 27 mbëritëm në Kucakë. Na bëri konak Monçi i Kucakës... Përveç çetës së Gorës e të Rrëzës, mëngjesin e datës 28 erdhën shumë veprimtarë nga Gora dhe Opari i Poshtëm, që kishin shprehur dëshirën për të kaluar partizanë në radhët e çetave...vëprimtarë të rinisë, komandantë të njësiteve të armatosur të fshatrave e patriotë të tjerë të kësaj krahine si: Xhezar Senisht, Zalo Zvarishti, Liko Gjyrasi, Hysen Bosi, Jaçe Bosi, Rakip Zvarishti, Ameli Dolani, Haxhi Dolani, Hasan Lesheci, (Miglica), Xume Protopapa, Shaban Zereci, Monçi Kucaka, Myslim Matraku, Sabri Plovishiti, Bektash Plovishiti, Qani Babjensji, Ceno Vrepcka, Limi Grybeci, Kadri Grybeci, Dilaver Qencka e shumë të tjerë."

Dr. Ymer Dishnica, për artin e komunikimit të Nexhipit dhe familjen e tij ka thënë: "...Shtëpia e tij (e Nexhipit-shën. im) kishte kohë që ishte bërë bazë kryesore e LANÇ-it. Ai që rritur në atë vatër ku era e barutit nuk qe shuar kurrë...Nexhipi na duhej në qendër në çdo çast, pasi ai ishte promotori i lëvizjes antifashiste". Më 16 shtator 1942, Nexhip Vinçani e shohim delegat në Konferencën e Pezës, si përfaqësues i Rinisë Antifashiste, ndërsa Ymer Dishnica ishte delegat i P. Komuniste... Nga shënimet që ai ka mbajtur në faqet e një fjalori italisht, lexojmë: "...U nisa ilegalisht për në Tiranë, i shoqëruar nga dy shokë të njësitit të Korçës me një makinë "MILECENTO", vetë isha disi i maskuar dhe me pasaportë fallo... Në Tiranë takova Esat Dishnicën. Me një "pajton" dhe 2 shoqërues nga Tirana, u nisëm për në Pezë..."

Sidomos pas Konferencës së Pezës, familja "Vinçani" ishte e përkushtuar me të gjitha forcat e mjetet me LANC, ku rolin kryesor tani e kishte brezi i ri i kësaj familje, Nexhipi me vëllezërit. Së bashku me Ymerin ata filluan ngritjen e këshillave NCL, duke nisur nga Vinçani e më pas me krijimin e njësiteve partizane. Nexhip Vinçani të habiste me magjinë e forcës organizuese të fjalës dhe të bënte të hidheshe në flakë. "Kur shkua për të organizuar një çetë partizane në zonën e poshtme të Korçës, ai ndriste dhe shkëlqente nga të gjithë në të deleguarit. Ai gëzonte një simpati të veçantë në të gjithë popullsinë e zonës, sepse shtëpia e tij ishte bërë një nga bazat më të fuqishme të luftës në të gjithë Qarkun e Korçës" Y. Dishnica.

Ndërkohë që armiku dhe bash-

këpunëtorët e tij kishin terrorizuar popullin, Nexhipi hynte familje me familje dhe u bënte thirrje që të mos gënjejeshin nga propaganda e të huajve. Kur forcat armike po dignin fshatin Osojë dhe banorët i futën në kishë për t'i pushkatuar, Nexhipi organizoi një sulm të befasishëm me Batalionin e -III- dhe gjermanët u larguan në panik, kurse banorët shpëtuan duke falenderuar forcat partizane dhe personalisht përfaqonin me lot në sy Nexhip Vinçanin. Personaliteti i ushtarakut Nexhip Vinçani u rrit edhe më shumë, ku më 28 dhjetor 1943, në Voskopojë, krijohet Brigada e IV Sulmuese dhe komandant u caktua Nexhip Vinçani, kurse komisar, Pëllumb Dishnica. Kjo brigadë zhvilloi luftime në 20 krahina të qarqeve: Korçë, Berat, Elbasan, Dibër, Durrës, Tiranë, Shkodër, etj. Në ceremoninë që u organizua për dorëzimin e "Flamurit luftarak" Nexhipi u përku, e puthi flamurin i përplotur dhe u betua përpara efektivit të Brigadës:

"Betohem se do ta mbajmë me nder e lavdi këtë flamur, edhe në momente më të rrezikshme, duke mos kursyer edhe gjakun tonë, si bij të denjë të këtij populli trim e të lavdishëm që, kurrë nuk i ka turpëruar armët e tij, kurrë nuk e ka lënë këtë Flamur ta nëpërkëmbin armiqtë e tij". Si një ogur shpresëdhënës, Brigada e IV-s, nisi luftën për të përballuar ofensivën armike, me një manovër të shkëlqyer, duke krijuar një situatë më të favorshme, në prag të Operacionit të Dimrit. Fuqia e besimi në fitore qendronte në njohjen e situatës dhe manovrimin e rrufeshëm të lëvizjeve të trupave nën komandën e Nexhip Vinçanit. Partizanët marshuan në rrugën Lavdar-Opar-Mazrekë-Qafa e Beçit dhe dolën në lindje të Skraparit, për të kaluar në sulm në shpinë të armikut e për të rivendosur situatën në Qark. Nexhipi në çdo rast do të gjendej i pari në sulm. Kurse "Shtabi i qarkut", ishte në merak për jetën e tij, ndaj e këshillonte që të ishte më i rezervuar: "Mbasi jam përgëzuar për suksesin, jam kritikuar, se nuk ruhesha në luftë duke më thënë: "Nëqoftëse do të vriteshe ti, kush do ta drejtonte luftën...?"

Shifra dhe fakte: "...Në fillim Brigada kishte 550 partizanë, organizuar në 4 batalione. Faqe lavdie e trimërie tregoi Brigada e 4 në Operacionin Armik të Dimrit 1943-44. Gjatë mësymjeve pranverore në bashkëpunim me batalionet "Reshit Çollaku", e dy batalionet e Brig.I S, çliruan: Rrëzën, Gor-Oparin, zona e Mokrës, e Pogradecit, Malit të Thatë, Pojanit etj. Luftime të ashra u zhvilluan kundër forcave gjemane në Qafë Thanë, Maliq, Grabovë, Pllocë, Guri i Kamjes, Krosnisht, Moçan, Osojë, Gjnikas, Malin e Dusharit, Qafa e Gjarpërit, Bitinckë e Bilisht". Inkuadruar në Divizionin e Parë Sulmues të ushtrisë ANCL çlirohen: Qarrishta, Zerqani, Mati, Homesh-Sofracan, Fushë-Alie, Greva, Melani, Mirdita, Peshkopia etj. Brigada e IV me Brig Parë, e të VIII shënoi faqe lavdie gjatë operacionit për çlirimin e Tiranës... Në 321 ditë të jetës së saj, Brig.IV S, ka përshkuar 2200 km rrugë në këmbë duke kryer 265 luftime e operacione. I dha atdheut 274 dëshmorë ndërmjet të cilëve: n/kmandanti i Brig. Pano Xhambalati, Xhaferr C. Lubonja, Riza Taçi etj, ndërkohë që i shkatoi armikut 2000 të vrarë e 200 robër e dëme të tjera materiale". N.Vinçani ishte organizatori kryesor i 8 batalioneve partizane për periudhën maj-gusht 1943. Në ditët e para të muajit korrik 1943 komandoi shtabin operativ të qarqeve: Korçë-Gjirokastrë-Berat. Në krahinat e Shqipërisë së Mesme e të Veriut, populli u bind për luftën e drejtë...e u rreshtuan në radhët partizane deri 2000 vetë, mes tyre, partizanë italianë e armenë, që kishin hyrë në LANC pas kapitullimit të Italisë, 1943" Ing. Myfit Guxholli, ish-partizan i Brig.IV & kr. i OBVL. Nexhip Vinçani tashmë ishte afirmuar si luftëtar i numër 1, njohës i terrenit, organizatori e çelësi i besueshëm i forcave partizane, i rrugëzgjidhjes së situatave luftarake të vështira. Edhe vet Enver Hoxha e ndiente nevojën të këshillohej me luftëtarin e sprovuar N.Vinçani, i cili e kishte treguar me vepra se sa i zoti ishte. Ja se si shkruan në kujtimet e tij, vet heroi i librit tonë, Nexhip Vinçani: "Enver Hoxha kishte arritur në Zvarisht në shtëpinë e Zalo Zvarishtit dhe kishte kërkuar të më lajmërojnë. I shoqëruar nga disa partizanë të Njësitit të Shtabit si: Selami Pronjarin, Kristo Mushin, Mika Dollakun, Skënder Vinçanin, Enver Vinçanin si dhe 2 korrierë, u nisa menjëherë për në Zvarisht. U takuam në shtëpinë e Zalos dhe atë natë qendruam mysafirë te Zaluja e biseduam për problemet që lidheshin me kushtet e punës, mbi situatën politike dhe ushtarake në Qark, mbi punët që po bënim për organizimin e ri të drejtimit ushtarak me anë të shtabit, organizimin e



## SPECIALE



## GJENERAL NEXHIP VINÇANI DHE BRIGADA QË S'U BË "HERO I POPULLIT"

batalioneve etj..."

"Enver Hoxha më ngarkoi dy detyra: Detyra e parë kishte të bënte me përgatitjen e një baze në hapësirën e qarkut tonë diku në thellësi, sigurimin e kushteve për punë e jetesë, sigurimin e ruajtjes etj. (mbasi udhëheqja e partisë do të punonte për një kohë atje, ku parashikoheshin dhe disa takime partiake të shteteve fqinje, Jugosllavisë dhe Greqisë." Për shkak se do të kishte mysafirë të huaj, së pari duhej marrë masa që të mos ndodhte ndonjë incident. Së dyti: "vendi" duhej të mos ishte shumë në thellësi, për shkak të vështirësive të pjesëmarrësve. "Ju afrova shtëpinë time në Vinçan, duke e siguruar se pavarësisht se është relativisht afër qytetit të Korçës, (7 km), kemi mundësi të marrim masa të plota sigurimi dhe pune. Pas disa ditësh u zhvillua mbledhja. Nga Jugosllavët, përveç Tempos dhe Miladinit, ishin dhe dy përfaqësues të Shtabit të Ushtrisë NCL të Maqedonisë, sikurse ishin dy përfaqësues të EAM-it grek. Nga ana jonë merrte pjesë: Enver Hoxha, Koçi Xoxe, Kristo Themelko, Pandi Kristo dhe unë (N.Vinçani).Bisedimet zhvilloheshin në frëngjisht. Në shtëpi, bashkë me shoqëruesit bëheshim 17 veta, por kjo nuk përbënte problem..."

Një nga meritat më të rëndësishme të tij ka qënë drejtimi i zgjuar i këtyre forcave për nxjerrjen e tyre nga rrethimi gjerman, në Operacionin armik të Dimitri, janar 1944. Çelësi i suksesit të tij qendronte tek fjala burrërore dhe shëmbulli personal. Lufta kishte plotë të papritura. Krerët drejtues u ndodhën para një situatë të vështirë. Ishin hedhur në tavolinë dy mendime: "Mendimi i K.Xoxes edhe i L.Gegës ndryshonte diametralisht me tonin", shkruan në kujtimet e tij Nexhipi. -Ata thoshin se edhe andej ku do të vemë, nuk do të gjejmë ndonjë situatë më të mirë, prandaj pa humbur kohë, të përfitojmë nga nata: forcat të shpërndahen, të kalojnë në prapavija, mundësisht të fshihen deri dhe të hyjnë ilegalisht në qytet dhe, kur të krijohen kushte të tjera, mbase deri në pranverë, të rimblidhemi e të vazhdojmë luftën".

Kurse Nexhip Vinçani e konsideroi këtë si "dorëzim pa kushte" përpara vështirësive. Ai u ngrit e tha me vendosmëri: "Në rolin e ushtarit, jam dakort, por në rolin e komandantit, unë nuk jam dakort për shpërndarjen e ushtrisë"... Përfundimi? U bë ashtu siç tha Nexhip Vinçani. Forcat partizane vazhduan luftën.

Gjatë viteve 1942-44 në gjithë Qarkun e Korçës autoriteti i Nexhipit ishte rritur së tepërmi. Kjo gjë shkaktoi një farë xhelozie tek disa udhëheqës kryesor të luftës. Për bashkëpunëtorët me armikun, Nexhipi kishte një qëndrim të prerë: "Për mua, -thotë ai, -ka qënë gabim fatal për vet organizatën e Ballit "bashkëpunimi me pushtuesit". Ashtu si ka qënë gabim fatal për Partinë Komuniste, varësia dhe nënshtrimi i plotë i udhëheqjes së saj ndaj Partisë Komuniste të Titos". Lidhur me rolin e Partisë Komuniste në luftën ncl, Nexhip Vinçani shkruan: "Partia komuniste ka qënë në udhëheqje, kjo është një e vërtetë historike dhe nuk ka përse të mohohet, por aq e vërtetë është edhe ajo që idetë komuniste ishin parësore në celulat tona..." Ai kishte ndërtuar marrëdhënie të ngrohta me ushtarët, ndërkohë që edhe ata e donin, e respek-

tonin dhe e kishin si mbështetje e siguri në fitore. Operacioni i Qershorit kishte protagonist në zonë pikërisht komandant Nexhip Vinçanin.

Në luftimet kundër gjermanëve për çlirimin e Pogradecit, më 23 tetor 1943 Nexhip Vinçani u plagos me një plumb që i mbeti në trup deri sa vdiq. (VR: Kur doli nga qelia dhe shkoi në drejtorinë e Sigurimeve për pensionin 100 lekësh... nëpunësi i tha: "Nuk të takon, se plumbin nuk e ke në organ kryesor". "O zot! Sipas jush, duhej të më kishte marrë në ballë...!?-tha në formë sarkazme Nexhipi dhe doli në derë. Kur do të çlirohej kryeqyteti i Shqipërisë, Nexhip Vinçani caktohet Zv/komandant i Shtabit të Përbashkët Operativ, ndërkohë që operacioni drejtohej nga Mehmet Shehu.

Dita e çlirimit, 29 Nëntor 1944, e gjeti Nexhip Vinçanin në kupolën e drejtuesve më të talentuar të vendit, shëmbulli i një luftëtari dhe organizatori që kishte dhënë prova për aftësitë e tij drejtuese në luftë dhëmbë për dhëmbë me armikun dhe ishte njeriu i duhur me perspektivë për udhëheqjen e ushtrisë e mbrojtjes e vendit. Fill pas çlirimit, Nexhip Vinçani emërohet komandant i Divizionit të Peshkopisë dhe mandej i Divizionit në Shkodër. Në tetor '45 niset me grupin e parë të komandantëve të shquar të lanc, për studime të larta ushtarake në Akademinë "Voroshilov" në ish-Bs, të cilën e përfundoi me rezultate të shkëlqyera. Ai i njihnte mirë gjuhët; frëngjisht, anglisht, italisht e rusisht. Falë inteligjencës dhe vullnetit të tij të hekurt, Nexhip Vinçani u bë një nga gjeneralët më të spikatur të ushtrisë shqiptare. Pas mbarimit të studimeve, kthehet në atdhe dhe në vitin 1948, emërohet komandant i Divizionit të Korçës e pas një viti emërohet drejtor i Drejtorisë Operative në Ministrinë e Mbrojtjes dhe zv/Shef i Shtatmadhorisë së Ushtrisë.

Në "Provokacionet e gushtit 1949", emërohet kryetar i grupit operativ të Komandantit Suprem dhe Shtabit të Përgjithshëm. Drejtoi luftimet bashkë me gjeneral-major Mehmet Shehun dhe kolonel Skënder Malindin.

Nexhipi për këtë kujton: "Në gusht 1949, në kohën që ishim në mbledhje, Enverit i çuan një copë letër në tavolinë. Ai ndaloj vazhdimin e mbledhjes: "10 minuta pushim!", tha. Ndërkohë, gjatë pushimit, më thirri mua e më tha:

-Nexhip, e ke plot me benzinë makinën?

-Po, - i thashë.

-Nisu menjëherë në Bilisht dhe zgjidh situatën, sepse grekët kanë sulmuar tokën tonë!..."

Po këtë vit, Kongresi I-rë i PKS -së e zgjodhi kandidat të KQ.

Bashkëkohësit e cilësonin si një psikolog i lindur me aftësi të rralla për të depërtuar në thellësinë e mendimit të bashkëbiseduesit. Ishte një njohës i shkëlqyer i territorit dhe njeri praktik. Kishte energji të pashtershme dhe fantazi, ideator i zgjidhjes së situatave të vështira. Gjatë LANC, N. Vinçani u çmua edhe nga populli i zonës si komandanti më i suksesshëm, më i ekuilibruar, më i kulturuar e më njerëzor.

Konsiderata të larta për komandantin Nexhip Vinçani do të shprehnin edhe të huajt, gjatë dhe pas luftës, madje disa syresh edhe në librat që kanë lënë

pas.

Mario Fantacci, një ndër partizanët italian të inkuadruar në formacionet shqiptare të luftës, në librin: "UN ITALIANO IN ALBANIA", ka shkruar: "... forcat partizane të këtij qarku mumëronin rreth 4000 veta të armatosur, të inkuadruar në batalione të ndryshme, çdo njëri prej të cilëve përbëhej nga 200 partizanë... Komandant i Përgjithshëm i këtyre forcave ishte Nexhip Vinçani, një avokat i ri, që kishte kryer studimet në Itali dhe që për trimërinë dhe zotësinë e tij të madhe ish bërë një komandant i shquar"

(Revista italiane "Movimento di Liberazione in Italia", (janar, mars, maj 1956 Facc.1-3, nr.40,41,42)

"Ideja e manovrës e komandant Nexhipit ish një gjetje e përkryer e një zbatim brilant artit ushtarak."

"Të shoqëruar dhe udhëhequr nga tre partizanë shqiptarë, sipas urdhërit, u nisëm për te komandant Nexhipi, i cili në krye të 5 batalioneve, zhvillonte luftime të ashpra kundër gjermanëve dhe ballistëve në Mokër".

Z. Smaill, do të shkruante për Nexhipin: "Më habit disiplina dhe autoriteti juaj që do t'juja kishin zili dhe gjeneralët me akademi ushtarake". Në një letër që ish-përgjegjësi i Misionit Ushtarak Britanik, Marcus Lyon, në Qarkun e Korçës, në vitin 1992, i shkruante Nexhipit: "... Ish një ofensivë e madhe gjermane dhe një përpjekje për të na rrethuar në të gjithë... Ju (N. Vinçani, shën. im) udhëhoqët Brigadën përmes borës dhe errësirës së natës në mes të rrethimit gjerman; dhe kaluam pak metër afër trupave të tyre deri lart mbi anën e malit të Ostrovicës... Ne duhet t'ju falenderojmë ju për këtë". Kurse, në letrën e M. Lyon (16.11.1992), ndër të tjera theksohet: "Në librat e mia rreth Shqipërisë, shpesh unë e kisha ngritur emrin tuaj në artikuj e gazeta, por pa sukses. Mendoj se është e tmerrshme kur dikush që bëri aq shumë në luftë kundër okupatorit gjerman, të trajtohet kështu!!!..."

Një paralele e njëjtë vlerësuese del edhe nga goja e një ushtaraku rus, (që ka qënë në Shqipëri) sjellë nga gjeneral Ramohitaj (në kohën kur ishte student në Moskë).

"Kam qënë këshilltar në komadën e Mbrojtjes Bregdetare, në degën e ndërlihdjes në Durrës. Komandën e drejtonte një gjeneral i famshëm, Vinçani, a e keni dëgjuar?!-tha folësi rus.



"Po, po, i thamë ne, por ai ka dalë tradhtar!"

Bashkëbiseduesi u shtang duke shtuar: "Nuk mund të ndodhë kjo. Gjeneralë të tillë nuk tradhtojnë. Ndoshta e keni marrë vesh gabim." Kur ne këmbëngulëm, ai hodhi lopatën dhe mërmëriti: "çjort vozmita=ta hajë dreqi! Kudo veprohet njësoj, të aftët i asgjësojnë!"

Kurse Nexhip Vinçani, në njërin ndër dhjetra letrat që u shkruan miqve të huaj, (ish-partizanë të Brig, IV-S), ka shkruar: "Në vitin 1957 më hoqën gradën e oficerit (gjeneral) e më dërguan në punë të vështira. Më cilësuan armik të Partisë Komuniste. Në moshën 66 vjet, në vitin 1982, pasi kisha 6 vjet në pension, më arrestuan me akuzën "për agjitacion e propagandë" kundër regjimit, më torturuan egërsisht në kushte plotësisht izolimi për 11 muaj, e së fundi më dërguan 5 vjet në internim. Ndër të tjera më akuzuan si "agent engles", sepse, kur më arrestuan dhe kontrolluan shtëpinë, më gjetën një fotografi ku unë së bashku me ju (të Misionit Ushtarak Engles) kisha dalë diku në malet e Shqipërisë jugore e atë foto e ruaja si një kujtim të shtrenjtë".

(Vijon në numrin e ardhshëm)

## ANALIZA

80-vjet nga Konferenca e Bujanit

IDEALET KOMBËTARE QË  
NUK U SHUANË KURRË

Nga Bashkim Hisari

Lufta e Dytë Botërore rezultoi si konflikti ushtarak më i përgjithshëm e më i përgjakshëm në historinë e njerëzimit. Në këtë luftë u shua jeta e miliona njerëzëve dhe u shkatërruan shumë vlera materiale, kulturore, historike e të tjera, të krijuara nga brezat ndër shekuj. Por, megjithëatë, lufta për liri mbeti e përhershme.

Në kohërat e ndërlikuara, të frymzuar nga vlerat lirishtetërore, shqiptarët, ndër të parët tubuan forcat patriotike e progresive në luftë kundër fashizmit.

Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare në Kosovë u zhvillua në kushte të vështira dhe të eksploatimit shekullor të shtresave të gjëra. Kosovarët u rreshtuan në anën e drejtë të historisë. Në luftën vendimtare kundër okupatorëve fashistë, luftuan bashkë me partizanët nga Shqipëria dhe çliruan jo vetëm Kosovën e Shqipërinë, por edhe viset tjera të ish Jugosllavisë. Fitorja ishte kurora e përpjekjeve këmbëngulëse për çlirim kombëtar e social.


Mobilizimi i tyre në luftë qe jashtëzakonisht i rëndësishëm e i guximshëm dhe i kontribuoi interesave kombëtare. Kjo ishte kurora e luftës për liri, vetëvendosje dhe demokraci.

Partia Komuniste e Jugosllavisë, fillimisht kishte përcaktuar disa ide të drejta dhe pragmatike për zgjidhjen e çështjeve nacionale, por ato dështuan për shkak të pengimit nga nacionalizmi serb dhe idesë për Serbinë e Madhe.

Përkundër faktit se shqiptarët ishin politikisht të përfshirë në aktivitetet e organizuara të lëvizjes për çlirim nga fashizmi dhe premtimeve se do të integrohen si entitet i Federatës dhe, si edhe të tjerët në Jugosllavi, do ta gëzojnë të drejtën e vetëvendosjes deri në shkëputje, këto nuk u realizuan. Kosova nuk u përfshi fare si entitet apo territor i veçantë kompakt në Jugosllavi, me të drejtën e shtet-ndërtimit mbi bazën e parimit të vetëvendosjes deri në shkëputje.

Në mbledhjen e organizuar në Jajce (Bosnjë dhe Hercegovinë), në nëntor të vitit 1943 ku nuk u ftuan përfaqësuesit e Kosovës, u vendos sistemi federativ jugosllav. U themeluan 6 republika që përfaqësonin 6 grupe sllave të quajtura kombe. Grupet tjera etnike joslave, kryesisht shqiptarët dhe hungarezët, u trajtuan si "pakica kombëtare" në bashkësitë territoriale "autonome". Shqiptarët ishin unik për çështjen kombëtare për vetëvendosje dhe synimi tyre ishte bashkimi i tokave shqiptare në një entitet. Andaj, më 31 dhjetor 1943 dhe 1 e 2 janar të vitit 1944, në Tropojë, fshatin Bujan të Malësisë së Gjakovës, përfaqësuesit e të gjitha shtresave të frontit antifashist nga Kosova dhe Shqipëria, partizanë, komunistë, nacionalistë, atëdhetarë demokratë, qytetarë të thjeshtë, punëtorë e fshatarë, madje edhe përfaqësuesit e pakicave serbe, malazeze e boshnjake, organizuan Konferencën e Bujanit ku e votuan Rezolutën që sanksiononte të drejtën e vetëvendosjes. Rezoluta e Bujanit që u miratua unanimisht, afirmoi dhe legjitimoi të drejtat për vetëvendosje si një atribut çlirimtar dhe dëshirë e kahershme e të vazhdueshme të shqiptarëve nga Kosova për t'u bashkuar me shtetin amë - Shqipërinë. Vendimet e Bujanit dhanë rezultate të jashtëzakonshme në masivizimin e Lëvizjes Çlirimtare dhe në zhvillimin e qeverisë demokratike. Ato përbënin momentin më të rëndësishëm për shqiptarët që jetonin në trojet e veta në Jugosllavi, për identitetin politik të Kosovës, për afirmimin e kërkesave legjitime, për konkretizimin e përpjekjeve në realizimin e të drejtës për vetëvendosje dhe mëvetësi. Këto të drejta i garantonin Aleatët e mdhenj Amerika, Anglija, Bashkimi Sovjetik (Karta e Atlantikut, Konferenca e Moskës dhe e Teheranit).

Mirëpo, Lëvizja e fortë antifashiste revolucionare në Kosovë dhe vendimet e Bujanit ishin pengesë e madhe për nacionalistët dhe hegjemonistët serbë. Ata tradhtuanë parimin e çështjes kombëtare, veçanërisht parimin themelor të së drejtës për vetëvendosje dhe shkëputje. Mohonin dhe keqinterpretuan vendimet e miratuara në Bujan. Në kohën kur njësitë e fundit të Ëehrmacht-it nga Grupi i Ushtrisë gjermane i gjeneralit Aleksandër Lehr tërhiqeshin nga Kosova dhe formacionet e partizanëve shqiptarë vazhdonin luftën, më 8 shkurt 1945, Tito lëshoi një urdhër për vendosjen e Administratës Ushtarake në Kosovë, që ishte organi i autoritetit ushtarako-shtetëror. Në vend të Fadil Hoxhës, nismëtarit të Lëvizjes Nacional - Çlirimtare, komandatit të aradhave partizane dhe organizatorit kryesor të Konferencës në Bujan,



komandant i administratës ushtarake në Kosovë emërohet koloneli Savo Drljeviq.

Dhjetë ditë pas vendosjes së administrimit ushtarak, u evolua plotësisht ideja e vetëvendosjes. Në pushtetin që e drejtonin kryesisht serbët, më 18 shkurt 1945, në Beograd, u debatua për Kosovën dhe statusin e ardhshëm të saj. Nga e tërë ajo që u fol, doli se zgjidhja më e mirë dhe më e drejtë, sipas tyre, ishte që, "Kosova e Metohia t'i bashkoheshin Shqipërisë, kurse Shqipëria të hynte në Federatën Jugosllave". Kështu, Kosova në mënyrë artificiale dhe arbitrare u aneksua nga Jugosllavia. Pasuan sulme të shfrenuara të sërbbomdhenjve që vazhdonin të diskualifikojnë, mohojnë dhe keqinterpretojnë vendimet e miratuara në Bujan. Dhoma Federative Jugosllave deklaroi se "Rezoluta e Bujanit është akt i pavlefshëm". Forcat drejtuese serbe në vazhdimësi përhapnin politikën antishqiptare në të gjitha drejtimet dhe format. Nënvlërësonin dhe minimizonin pjesëmarrjen e shqiptarëve në LANÇ. Kundrejt shqiptarëve silleshin me mendjemadhësi, kryelartësi, arrogancë, me kërcnime e diktate nga pushteti. Për të nënshtruar Kosovën plotësisht në aspektin politik, ekonomik, social, shpirtor etj., vendosin kuadrot e tyre kudo, ata që shantazhonin, diskriminonin dhe vritnin shqiptarët e pafajshëm. Dhunë, terror dhe ekzekutime fizike u ushtruan sidomos ndaj organizatorëve dhe nënshkruesve të Rezolutës së Konferencës së Bujanit. Nga UDB-ja vriten Hajdar Dushi, Xheladin Hana, Rifat Berisha, Halim Spahija. Dëbohet nga Kosova Zekeria Rexha. Ndiqen dhe persekutohen Xhafer e Bie Vokshi.

Në mendjen e shqiptarëve, serbosllavët ishin sinonim i së keqës. Andaj, në rrjedhën e raporteve politike organizonin forma të ndryshme të kundërshtimit. Në demonstratat e studentëve dhe intelektualëve shqiptarë të Kosovës në vitin 1968 dhe në ato gjithëpopullore në vitin 1981, u kërkua Republikë e më shumë të drejta dhe ato të zbatohen ashtu siç është kërkuar edhe në Konferencën e Bujanit. Mirëpo, kërkesat e tyre, serbët i kualifikonin si nacionaliste, irredentiste dhe kontrarevolucionare për ç'arsye, forcat e sigurisë jugosllave, ndaj demonstruesve u sollën me shumë vrazhdësi, vendosën tanket para institucioneve kryesore dhe dënuan shumë demonstrues. Më 23 mars të vitit 1989, Serbia e cila në atë kohë kishte në krye të shtetit kriminelin Slobodan Millosheviq vazhdoi lëvizjen antishqiptare. Në Kuvendin e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, në kundërshtim me vullnetin e qytetarëve, ndryshoi Kushtetuta e vitit 1974, me çka suprimohet autonomia e Kosovës në Federatën Jugosllave,

• Në Serbi asgjë nuk ka ndryshuar. Pushteti i kombit të vonuar serb, i ngarkuar me të kaluarën primitive. Mungon liria, drejtësia fjala e lirë, zbatimi i ligjit dhe i parimeve civilizuese e demokratike. Edhe 80 vjet pas Konferencës historike të Bujanit vazhdon të mohojë të drejtat legjitime dhe vullnetin e popullit shqiptar të Kosovës për vetëvendosje e pavarësi. Dikur ishte Slobodan Millosheviq, sot janë Vuçiq, Sheshel, Daciq... Pushteti autoritar funksionon me sistemin ku vazhdimisht bashkëjetojnë politika-krimi-policia-biznesi, mediat. Pushteti mbrohet me kordonët policor, me represione me gënjeshtër dhe me përhapjen e së keqës. Serbia nuk është zbrapsur në raport me Kosovën. Nuk respekton marrëveshjet e arritura. Por, idealet historike të kombit shqiptar nuk mund mohohen e as të shuhën.

duke e lënë Kosovën si pjesë përbërëse të Serbisë. Por, më 2 korrik 1990, delegatët e zgjedhur të Kuvendit të Kosovës e shpallën Kosovën Republik. Kjo shpallje ndodhi nën okupimin serb dhe në atë kohë ishte akti më i rëndësishëm dhe më i guximshëm i përfaqësuesve të popullit që nga Konferenca e Bujanit, Paraqitja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe lufta e fundit kundër forcave ushtarake-policore dhe paramilitare serbe të cilat kryen krimet më të rënda, reflektoi besnikrisht vijën politike të Bujanit dhe ishte shkëndia bindëse që jetësoi lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Me luftën e UÇK-së, me mbështetjen e forcave të NATO-s dhe me përkrahjen e gjithë popujve të civilizuar, u realizua vullneti i popullit të Kosovës për të qenë i lirë dhe i pavarur.

Forcat politike drejtuese serbe, me retorikën e tyre hegjemoniste me plot urrejtje ndaj shqiptarëve, po vazhdojnë t'i mohojnë vendimet dhe idealet kombëtare të shqiptarëve. Nuk dëshirojnë marrëdhënie normale, rrezikojnë paqen, sigurinë dhe rrugëtimin e Kosovës në integrimet evropiane.

Kjo është një histori për fatin e kombit të vonuar serb, të një shoqërie të ngarkuar me të kaluarën primitive, ku mungon liria, drejtësia dhe fjala e lirë. Shoqëria serbe është e pandjeshme dhe indiferente ndaj të keqës që serbët kanë bërë dhe po bëjnë ndaj shqiptarëve dhe Kosovës. Kanë një pushtet që po bën çmos të vonohet edhe më shumë në zbatimin e parimeve civilizuese e demokratike. Problemet e Serbisë karshi Kosovës dhe shqiptarëve, nuk janë vetëm Millosheviq, Vuçiq, Shesheli, Daciqi, Vulini, Mladiqi, Karaxhiqi... dhe kriminelët tjerë të dënuar në Gjykatën e Hagës për krime lufte, por problemi i tyre është nacionalizmi, shovinizmi, aspiratat hegjemoniste, mungesa e njerëzve të ndershëm në shoqërinë ku dominojnë malipulantët, gënjeshtarët, mashtruesit, kontrabandistët, kriminelët, mediat e karruptuara që retushojnë realitetin, falsifikojnë historinë dhe frikësojnë popullin. Duke anuar në ideologjinë neofashiste ata, heshtur dhe në mënyrë djallëzore anashkalojnë krimet e bëra në Kosovë dhe në viset tjera të ish Jugosllavisë.

Serbia po dërgon ushtrinë e saj në kufi me Kosovën. 25 vite pas luftës së fundit, po tenton të rinisi luftë, për të aneksuar Veriun e Kosovës që u dëshmuar më 24 shtator 2023 kur në Banjskë të Zveçanit, një grup të terroristëve serb të armatosur sulmuan Policinë e Kosovës.

Populli shqiptar ka marrë vendimet historike. Në Kosovë liria dhe pavarësia ka ndodhur, është fituar me gjak dhe nuk mund të anulohen e të mohohen. Kosova është shtet i lirë i pavarur dhe demokratik.

## VEPRIMTARITË

OBVL dhe Org. Dëshmorëve kanë programuar një varg aktivitete për kujtimore dhe promovimesh

# Madhështia e Pukës në 80-vjetorin e çlirimit të Atdheut



**Xhemal MEÇI**

**Studiues & "Mjeshtër i Madh"**

Kur sapo ka nisur viti jubilar i 80-vjetorit të çlirimit të atdheut nga okupatorët nazifashistë, degët e OBVL dhe të Organizatës së Dëshmorëve Pukë kanë programuar disa veprimtari për kujtimore.

**SË PARI**, - 110-vjetori i hapjes së shkollës Shqipe të Kabashit (1914 - 2024). Kjo ngjarje shënuar do të përkujtohet me krenari, edhe për faktin e shumë prituri se mesimi shqip ka filluar aty, në Manastirin e Shën Palit Pukë, afro 13 shekuj më parë (1378 - 2024 = 646 vjet më parë) në një shkollë fetare të këtij Manastiri të famshëm, Benediktin e Shpalit Pukë. Për këtë është evident kontributi i Dr. Mark Palnika, i cili ka siguruar dokumenta nga arkivat e Vatikanit dhe vazhdon të hulumtojë me përkushtim. Pa ndonjë ndihmë shtetërore, nga Ministria e Kulturës apo Akademia e shkencave, ky studiues i zellshëm ka botur mijra faqe, në libra të veçantë, si "Pulti, relacionet e Shtjefën Gasprit" (të vitit 1671) e tjerë, një pasuri e madhe kjo për Historinë e Kulturën tonë Kombëtare Shqiptare.

Në Kabash të Pukës, më 1912 erdhi imam i fshatit Kabash Sadik Prishtina, i arratisur politik për t'iu shpëtuar persekutimeve barbare serbe.

Duke përfutur nga mirëpritja e kabashëve myslimanë, të dhënë pas besimit të fesë e të kulturës islame, iu vu punës për rihapjen e mejtepit në SHQIP (shkollë filllore fetare) që sapo e kishte filluar imam Sadik Isuf Arifaj nga Iballa. Po tani, më 1914, mejtepi i zhvillonte mësimet shqip, duke i bërë më të kuptueshme e më tërheqëse për nxënësit po me alfabetin shqip. Prandaj ky vit, 1914 quhet fillimi i shkollës shqipe në Kabash.

I ndjeri Ymer Kadri Furriku, një prej nxënësve të parë të kësaj shkolle ( mejtepi) tregonte se: "Kemi pasë edhe raste kur filluan të vijshin të rinj të besimit katolik. Dy nxënës i kujtoi edhe unë prej Dedajve të Pukës".

**SË DYTI**, - 90 VJETORI (1934 2024) I SHKOLLËS SË FSHATIT KRYEZI. Në këtë shkollë që mban emrin "Shtjefën Gjeçov Kryeziu", mësues i parë u emërua Filip Lacuku, që iu përkushtua për 6 vjet, derisa më 1940 pushohet si antifashist. Për mungesë të lokalit shkollor mësimet i pat zhvilluar në kullën e plakut patriot e arsimdashës Nikollë Rrapi deri sa u ndërtua shkolla e re e Kryeziut me interesimin e Ndre Mjedës.

**SË TRETI**, do të përkujtohet 20-vjetori i Dëshmorit të Atdheut Allaman Nuhi Dervish Kryeziu,

rënë në krye të detyrës më 24 Maj 2004. (Kjo përkujtimore mund të përfshihet në veprimtari të 90 - vjetorit të shkollës, me që 8-vjeçaren ky dëshmor e kreu në atë shkollë).

**SË KATËRTI** do të zhvillohen veprimtari kushtuar 88-vjetorit të MIGJENIT NË PUKË (1936 - 2024). Me rastin e 11 tetorit, ditën e ditëlindjes së Tij, shpresohet të dilet edhe me Botimin "MIGJENI PËRSËRI NË PUKË", meqenëse Migjeni është i pranishëm në Pukë si i vlerësuar e i përkujtuar në komunitetin pukjan, si askund gjetiu në Shqipëri e jashtë saj.

Prandaj inderuari Zotni Kadri Morina, biznesmen me ndjenjën e humanistit të shquar do ndihmojë me financime botimesh nga vendlindja dhe jo vetëm. Ndërkohë Presidenti i ËUROSIG & INSIG, Z.Morina, duke e parë Shkollën Muze "MIGJENI" si godinë në degradim; iu përgjegj thirrjes së Bashkisë Pukë (kryetarit zotni Rrok Dodaj) për rikonstruksion total. Shpresojmë të përfundohet deri më 11 tetor, ditën e ditëlindjes së Migjenit, kur do të zhvillohen edhe veprimtari e 88 - vjetorit "MIGJENI NË PUKË". Është i pakuptimtë fakti që Bashkia ende, tash më se 3 muaj nuk ka emruar Ciceronin, mungesa e të cilit ka sjellë pasojë, duke mbetur dy muzetë e qytetit Pukë të kyqur pa shërbimet e duhura, me pretekstin se e kryen shërbimin e Ciceronit përgjegjësi i Pallatit të Kulturës, i cili edhe pse pa arsim përkatës, shprehet se "e kryej unë"! Bile për mungesë takti e mirëkuptimi drejtor - mvertës edhe si koreograf e " bëj unë"! Kur këtë sektor artistik e kryen me sukses pranë Pallatit të Kulturës Pukë tash 50 vjet artisti i talentuar R. Hoxha, vlerësuar me shumë Diploma e Çartifikata Nderi në kuadër të "Ansam-



Shkrimtari F. Kraja me mësuesin A. Hoxha, Kabash, 1967.



Pjesëmarrës në ceremoninë e përirimit të emrit të shkollës "Sh.Gjeçov Kryeziu" (H.Furriku, D.Pershpal, autori, M.Cufaj)

blit Puka", prandaj mban edhe titull nderi, "Qytetar Nderi i Bashkisë Pukë". Për probleme të tilla duhet më shumë vëmendje nga Zyra e Burimeve Njerëzore, si edhe nga vetë N/kryetari i Bashkisë Pukë. Se 80-vjetori i çlirimit të atdheut po afrohet çdo ditë e më shumë!

**SË PESTI**, do të promovohet Muzeu i DËSHMORËVE TË ATDHEUT PUKË. (Për këtë kemi marrë një premtim verbal prej Kolonel Bilbil Dervishit, nga familje e dy dëshmorëve të atdheut. Në këtë kuadër do të ketë ceremoni dorzimi të dokumentacionit për Dëshmorët e shpallur të Atdheut nga Puka. Krahas këtij promovimi do të shpalen edhe emërtime sheshesh e rrugësh me emra dëshmorësh të Pukës. Për këtë nismë humane na ka premtuar mbështetje, Zoti Rrok Dodaj - Kryetari i Bashkisë Pukë. Sigurisht besojmë se këtë nismë do ta përkrah edhe kryetari i Bashkisë Fusharës, Zoti Hilë Curri, nga familje me tradita patriotike, duke i dhënë Atdheut dy dëshmorë.

**SË GJASHTI**, do të zhvillohet Simpoziumi "PUKA PËRKUJTON 80 -VJETORIN E ÇLIRIMIT" ku do të kumtohet për çtat e para partizane të Pukës, Brigadën e VI -S, Brigadën e XXII-S edhe "BATALIONIN PARTIZAN PUKA". Gjithashtu do të përkujtohen veçanërisht dëshmorë të atdheut pukjanë, rënë brenda dhe jashtë kufijve të RSH, si edhe dëshmorë partizanë të rrethëve të tjera, rënë për çlirimin e Pukës. Sigurisht do të ketë edhe promovime librash dhe veprimtari artistike me raste ditësh përkujtimore patriotike etj.

Nismën për planifikimin dhe realizimin e këtyre veprimtarive e kanë marrë Dega e OBVL Pukë me kryetar Z.Lekë Curri dhe Organizata e Dëshmorëve të Atdheut, Dega Pukë me kryetar RasimCina - familje Dëshmorë, Nënkryetar - Liza Voci - familje Dëshmorë, Sekretar Xh. Meçi - failje dëshmor dhe, veterani Gjon Frok Deda. Falenderojmë për gatishmërinë e shprehur për të na ndihmuar Kolonel Bilbil Dervishi nga familje dëshmorë, Ing. Kol Deda nga familje Dëshmorë, (me tre dëshmorë të Atdheut). Po ashtu edhe administratori i ish- Komunës Rrape, Pllumbesha Laska që po njihet me historikun e shkollës së mirënjohur të Kabashit dhe po konsideron mundësinë e një donatori për ndihmë, (sigurisht jo në nivelin e Zotni Dedë Maluta që ndihmoi me 3 milion lekë të reja për 120-vjetorin e Shkollës shqipe Iballë). Megjithatë ka optimizëm.

## 82 VJETORI I LINDJES

UDHËTIM I SUKSESSHËM NË JETË, I NJËRIT NGA "DJEMTË E E GEGHYSENTIT" - "NDERI I KOMBIT"

# ALI DEMUSHI – Profili i kolonelit 82 vjeçar, kryetar i OBVL Shkodër



## Halil RAMA – Mjeshtër i Madh

82 vite jetë të Nënkolonel Ali Demushit, Oficer i Ushtrisë Shqiptare, sot në pensionin në qytetin Shkodër, nuk janë pak. Veprimtari jetësore aktive, shkollime në të gjitha nivelet, punë e rezultate të admirueshme në edukimin fiziko-ushtarak e aftësimin luftarak të efektivave të strukturave të mbrojtjes, ushtarë aktivë e rezervist, nxënës e studentë të shkollave të mesme e të larta, por edhe si publicist.

Aliu është një nga "Djemtë e Geghy-senit", "Nderi i Kombit" të Malësisë së Gjakoves (Tropojës), që më 14 janar 2024 mbushi 82 vite jetë, duke gëzuar shëndet të plotë dhe mjaft aktiv në jetën e përditshme.

Arsimin fillor e kreu në shkollën "Migjeni" në qytetin e Pukës, ndërsa shkollën 7- vjeçare në fshatin e lindjes, në Geghysen në vitin 1955.

Me dëshirën e tij dhe nxitjen nga babai Ibrahim Denushi, i cili ishte një arsimdashës i përkushtuar për shkollimin e fëmijëve, studio e përfundoi mësimet në shkollën e mesme Ushtarakë "Skënderbej" në Tiranë nga viti 1957-1961, me rezultate të mira. Pas përfundimit të kësaj shkolle e cila është quajtur me të drejtë "Fidanishja e Ushtrisë", vazhdoi e përfundoi studimet në shkollën e Bashkuar të oficerëve në Tiranë nga viti 1961-1963, duke u titulluar oficer me gradën "Nëntoger i këmbërorisë". Gjithashtu mbas një periudhe prej dy dekadash, studioi e përfundoi Akademikën e Lartë të Mbrojtjes (të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë) në vitet 1981-1983 në Tiranë, duke u aftësuar për drejtim e komandim njësisht të larta, ushtarakë, ku pati rezultate të larta.

Burimi kryesor i nxitjes dhe dashurisë për të vazhduar këto shkolla ushtarakë e për tu bërë kuadër i ushtrisë Shqiptare, ishte ushqyerja në vadhimësi me traditat atdhetare e patriotike të trungut familjar e të familjes së tij, të dëgjua në bisedat familjare nga babai, të afërmit e shumë bashkëvendas të moshuar kur kuvendonin në "Odat e Burrave" të Malsisë.

Në harkun kohor prej rreth dy shekujsh e deri në ditët e sotme, "Dera e Demushit" ka qënë dhe është e njohur në Malësinë e Gjakoves, në Kosovë e Plavë e Guci, prej së cilës kanë dalë

disa breza djemsh e burrash, që janë njohur e kanë bërë histori me dinjitet të lartë për atdheun e kombin shqiptar. Aliu gjenetikisht i përket kesaj dere e këtij trungu familjar si pasardhës i saj.

## KARRIERA E SUKSESSHME NË REPARTE E NJËSI USHTARAKE

Pasi u diplomua oficer me gradën "Nëntoger në vitin 1963, e filloi karrierën e tij si kuadër ushtrisë. Fillimisht emërohet në Brigaden e këmbërorisë (Brk) në Gramsh, ku shërben dy vite 1963-1965 në detyrën kryesore Shef i Fiskulturës për njësinë (Brk), duke qënë njëherësh edhe Sportist në klubin sportiv "Partizani" në Tiranë, në sportin e atletikes dhe qitjes me armë luftarake. Me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes të asaj kohe transferohet në (Brk) Tropojë, ku shërben dy vite 1965-1967, në detyrën e komandantit të Kompanisë Art -mitraliere e atë të shefit të stërvitjes së brigadës. Aty mbajti gradën "Toger" deri sa u hoqën gradat në ushtri sipas modeli kinez në vitin 1966-të.

Në fundvitin 1967 me Urdhër të Komandes së Korpusit në Shkodër transferohet në Brk në Vau Dejes me detyrë Shef stërvitje i Brigades të cilën e kryen deri në mesin e vitit 1969. Ishte detyra më e vështirë për kohen sepsë Shqipëria kishte dalë nga Traktati i Varshavës më 1968 dhe e gjithë brigada e Vaut Dejes kishte kaluar në gatishmëri luftarake numër një (nr.1). Për atë kohë në kujtimet e tij, Aliu thotë se për dy muaj rresht nuk mu hoqën çizmet prej këmbëve as ditë, as natë. "Isha në një vend diskollim ku merresha me përgatitjen dhe aftësimin e rezervistëve për të përdorur armët dhe municionet luftarake. Me shumë përgjegjësi, po edhe me rrezikshmëri ishte mësimi për përdorimin e granatave të dores, luftarake, offensive e defensive", tregon kolonel Demushi.

Me futjen e edukimit ushtarak në shkollat e mesme dhe të lar-

ta në vitin 1969, si komponent i shkollës, me Urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, Aliu emrohet zv/drejtor ushtarak në gjimnazin "28 Nëntori" në Shkodër, detyrë të cilën e kryeu për 8 vite rresht (1969-77). Në ato vite përgatitja ushtarakë e nxënësve dhe studenteve ishte e një niveli të lartë. Kjo edhe për faktin se ishte nota në edukimin ushtarak që përcaktonte kalueshmërinë e nxënësve e studenteve. Aliu kujton me nostalgji atë lloj përgatitje të nxënësve e mësuesve sepe në çdo kontroll që bëhej nga dikasteri i mbrojtjes dhe i arësimit, Shkolla "28 Nëntori" dallohej për rezultate të larta në shkollë Republike. Në fushimet pranë qendrave të stërvitjes, nxënësit, me pamjen e jashtme, me përgatitjen e gatishmërinë e tyre ishin ushtarë të vërtetë, aq sa dëshironim që të tillë të ishin edhe ushtarët aktivë e rezervistë të reparteve ushtarakë. Aty, -shprehet Aliu, kisha një mbingarkesë sepe komanda e Korpusit më ngarkonte për stërvitjen edhe të dy shkollave të mesme të Lezhës apo dy-tre shkolla të qytetit Shkodër, duke përfshirë edhe shkollën e mesme të Fushë Arrezit të Pukës, njëherësh, në të njëjtën kohë, kur isha përgjegjes për sigurimin e kushteve për jetesë, për stërvitje, rregull e disiplinë. Por me një organizim, planifikim, drejtim e komandim të mirë e kemi kryer detyren duke dalë faqebardhë, ku për punë të mirë, jam dekoruar me Urd-

hër "Naim Frashëri" klasit dytë me rastin e festës së 50-të vjetorit të Gjimnazit të Shkodrës.

## KOHA KUR I GJITHË POPULLI ISHTE USHTAR

Me hapjen e shkollave të Lira ushtarakë, (SHLU) Aliu e gjejmë komandant i SHLU në Koplík të Malësisë së Madhe e më pas komandant batalioni këmbësoria (bk) në Gruemirë, në përbërje të Brk Koplík në vitet 1977-1981. Për përmbushjen me sukses të këtyre detyrave, Aliu me aftësitë dhe përkushtimin që e karakterizonin si dhe në bashkëpunim të ngushtë me organet e pushtetit dhe të ekonomisë bëri të mundur që SH.L.U të Koplíku ku stërviteshin të gjitha strukturat e mbrojtjes me, ushtarë aktivë, rezervistë. Forca Vallnetare e rini shkollore të armatosur ta rendiste në një nga shkollat e dalluara të Korpusit të Shkodrës. Në këtë periudhë me një punë tre vjeçare, bëri të mundur që batalionin e këmbësorisë në Gruemirë ta nxirrte nga prapambetja e theksuar e me mjaft probleme e ta rendiste, në batalion shembullor. Është për tu kujtuar stërvitja treguese e një nënreparti në mbrojtje me qitje luftarake që organizoi e zhvilloi para kuadrove oficer të Korpusit Shkodres. Gjithashtu rezultati i qitjeve me artilerinë e batalionit në kuadrin e qitjeve me grupimin e artilerisë së Brigades, ku u vlerësua me notën mesatarisht 9-të për artilerinë mortajë dhe topat kundër tank, nga inspektimi i Ministrisë së Mbrojtjes ishin arritje të vlerësimit "shembullor".

Pas përfundimit të Akademisë së Mbrojtjes në vitin 1983 Aliu u rikthye në Korpusin e Shkodrës, ku me Urdhër të Ministrisë të Mbrojtjes u emërua me detyra të nivelit të lartë si shef operativ e shef Shtabi Brigade Këmbësorie, në Rrenc të Shkodrës, në Koplík dhe Vau Dejes.

Me njohurit teorike që mori në Akedeminë dhe aftësitë që shpalosi kudo ku punoi në njesitë e lartpërmendura, pati rezultate të mira, e të larta ku për këto arritje është dekoruar me Urdhërin për Shërbimin Usharak. Detyrat që ka kryer në Brigadat e këmbësorisë e kanë aftësuar më tej si shtabovik. Ato kanë qënë detyra që janë konsideruar çelësi i njesive ushtarakë, ku është bërë planizimi stërvitor dhe planizimi luftarak për kohë luftime i secilit repart veç e veç dhe i njesive në terësi.

(Vijon në faqen 16)





## AKTUALITET

Sipas shkrimtarit dhe gazetarit disident Mustafa Greblleshi, dëshmitar okular, i planifikuar për t'u pushkatuar

# 4 shkurti 1944 - Një natë masakrash në Tiranë

Në librin e Mustafa Greblleshit "Kujtime 1939-1944" faqe 94-96, botim i Sh B Çabej viti 2017 shkruhet: "Nata e 4 shkurtit 1944 pat qenë një natë masakrash për Tiranën, sikundër pat qenë nata e Shën Bartolomeut për Parisin.

Më se 100 qytetarë të pafajshëm u morën natën nga gjiri i familjeve të tyre dhe u pushkatuan para portave të banesave ose nëpër rrugicat e lagjeve. Qindra të tjerë u arrestuan.

Atë natë trokitën edhe në portën e shtëpisë sime.

I shpëtova arrestimit duke u fshehur në kopshtin që kisha prapa shtëpisë, në fund të të cilit kalonte përroi. Policia kontrolloi më kot shtëpinë, nuk më gjeti. Të nesërmen pasdreke trokiti në portën e shtëpisë Pol Zhegu, i cili më pat arrestuar edhe tre vjet më parë, kur u përleshja në demonstratë me italianët. Atëhere Pol Zhegu ishte karabinier i karabinierisë italiane, ndërsa tani xhandar i xhandarmërisë shqiptare.

-Të kërkojnë në komandën e qarkut-, më tha Pol Zhegu.

Në komandë të qarkut ishte bërë zot Xhelal Staravecka, dezertor i ushtrisë nacionalçlirimtare, i graduar kapiten, i shëndrruar në bishë. Me anë të terrorit të shfrenuar që ushtronte, ai e kishte tmerruar Tiranën.

-Paraqitem vetë-, i thashë Pol Zhegut.

-Kam urdhër të të marr të shoqëruar-, ma preu shkurt ai.

E pashë punën pisk. Me Pol Zhegun ishim bashkëbanorë të një lagjeje. Unë njihja mirë edhe të jatin, Tal Zhegun, që kishte qenë kryeplak i lagjes para okupacionit fashist. Në emër të kësaj njohjeje, iu luta të më lejonte me një karrocë deri në hotel "Dajti", sa të njoftoja një eprorin tim. Pol Zhegu pranoi. Pra ma bëri këtë të mirë dhe nuk ja harroj, megjithse më vonë Pol Zhegu



pati një fund tragjik.

Në dhomën 333 në hotel "Dajti" (e mbaj mend ende këtë numër me tre tresha) banonte Xhelal Mitrovica, sekretar i përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës dhe nipi i kryeministrit Rexhep Mitrovica. Ai më donte dhe i shtyrë nga kjo dashuri, më çmonte si gazetar më shumë se ç'vleja. Sillej me mua si shok i një rangu, pavarsisht nga posti që kishte. Për fat të mirë e gjeta në dhomë. Më priti shumë ngrohtë dhe më dëgjoji me shumë vëmendje. Në fund më tha vetëm kaq: "S'ka gjë, shko paraqitu!"

Unë qëndrova një grimë i heshtur, për ti dhënë të kuptonte se nuk ishte diçka e lehtë të paraqiteshe te Staravecka, të shkoje ashtu me këmbët e tua si çjapi te kasapi. Mirëpo ai, edhe pse e dinte mirë cili ishte Staravecka, fare i qetë më përsëriti atë fjalë: - Shko, paraqitu!

Prapa derës së dhomës 333 në korridor më priste Pol Zhegu dhe te hyrja e hotel "Dajti" karroca që më shpuri në komandë të qarkut.

Pol Zhegu trokiti në zyrën e Xhelal Staraveckës, hapi derën, përgjysmë dhe më tha të futesha.

Xhelal Staravecka kishte një trup të imët, nën mesatare, me një fytyrë të mprehtë e të zeshkët. Ndoshta shtati i tij mund të arrinte edhe mesataren, por m'u duk i rrëguar, ndoshta për shkak se dhoma ishte shumë e madhe. Dhoma ngjante më shumë me një kthinë kazerme se sa me një zyrë.

Sytë e tij të ndezur e të lëvizshëm shprehnin qartas duf, urrejtje, etje për hakmarrje, për

krime, për mizori. U ngrit në këmbë kur hyra unë. Më vështroi një hop me ata sy, që herë shkrepnin, herë terratiseshin dhe shfreu duke i rënë tavolinës me grusht me sa fuqi kishte. Pastaj tha vetëm një fjalë, që ishte më fort një britmë.

-Shko!

E mora me mend se Xhelal Mitrovica e kishte marrë në telefon para se të arrija unë.

Dhe, siç e mora vesh më vonë nga Gjergj Bubani, Staraveckën e kishin informuar sikur e kisha shkruar unë një trakt që i kishin gjetur një vajze të arrestuar. Kjo informatë ishte një shpifje. Unë kurrë nuk kisha shkruar ndonjë trakt".

## NGA KRONIKAT E KOHËS:

Më 4 shkurt 1944 në Tiranë u krye masakra më çnjerëzore, ku pas nje atentati kunder makines se tij ku u vra nipi i tij, ministri Xhaferr Deva u dha urdher forcave te regjimentit "Kosova", te xhandarmarise etj, dhe ata vrane 84 persona (nga te cilet rreth 45 jane te identifikuar).

Komanda e Xhandarmërisë Shqiptare në raportin e saj të nesërmen në dt 5 shkruan: "Forcat e xhandarmërisë, së bashku me forcat e Regjimentit "Kosova" dhe me vullnetarët e Ballit Kombëtar, këtë natë kanë bastisur 230 shtëpi, ku kanë arrestuar 478 persona të dyshimtë dhe nga këta 84 më të rrezikshmit i kanë pushkatuar.

Nga të 84 të pushkatuarit rezultoi se 67 janë shqiptarë, 9 italianë, 4 malazezë, 2 maqedonas, 1 grek (minoritar) dhe 1 çifut. Viktimat shqiptare kanë qenë 29 nga Tirana dhe 37 nga rrethet Fier, Korçë, Durrës, Shkodër, Vlorë e Dibër". (AQSH, Fondi 1230, dosja 134).

Kjo deklaratë e Ministrit Xhaferr Deva është botuar në Gazetën "Bashkimi i Kombit" në datën 4 shkurt 1944: "Gjaku don gjak! Terrori kërkon terror! Nuk do të përtërihet shteti shqiptar as me gjykata, as me anketa, as me këshilla. Shteti shqiptar mund t'i kalojë këto faza kritike vetëm duke përdorur shtatën... për t'u vendosur në tërësi paqë, duhet të përdoret

thellësisht terrori... Terror kundër terroristëve, terror kundër anarkistëve, terror kundër nacionalçlirimtarëve, terror kundër simpatizantëve të saj".


## NJË NGA NGJARJET MË TË EGRA ÇNJERËZORE

80 vjet më parë, në natën e 4 shkurtit të vitit 1944, kuislingët nën urdhrat e pushtuesve nazistë vranë 84 persona brenda një nate dhe arrestuan 300 të tjerë në Tiranë. Masakra e 4 shkurtit 1944 në Tiranë është ndër masakrat më të përgjakshme, që kryen nazistët gjermanë dhe bashkëpunëtorët e tyre: si Xhafer Deva, Ministër i Brendshëm i nazistëve, Kadri Cakrani, komandant i forcave të Ballit Kombëtar, Qazim Mulleti, Prefekti i Tiranës, fashisti Osman Kazazi etj., nën drejtimin e Gestapos gjermane. Natën e 4 shkurtit drejtuesit e xhandarmërisë, me lista në duar e me grupe xhandarësh u futën nëpër shtëpitë e qytetarëve të Tiranës, rrëmbyen djem e burra dhe i pushkatuan nëpër rrugë. Për të futur frikë e tmerr, për të terrorizuar popullin, ata vepruan mbarë, pushkatuan edhe të tjerë që i gjenin në rrugë. I vrisnin dhe i masakronin barbarisht, duke i gjymtuar edhe për së vdekuri, pastaj i hidhnin nëpër kanale, apo dhe në mes të bulevardit. Rrugët e Tiranës u mbushën me gjak. Përmasat e kësaj masakre i pohon të nesërmen Komanda e Xhandarmërisë në raportin e saj ku thuhet: "Forcat e xhandarmërisë, së bashku me forcat e Regjimentit "Kosova" dhe me vullnetarët e Ballit Kombëtar, këtë natë kanë bastisur 230 shtëpi, ku kanë arrestuar 478 persona të dyshimtë dhe nga këta 84 më të rrezikshmit i kanë pushkatuar. Nga të 84 të pushkatuarit rezultoi se 67 janë shqiptarë, 9 italianë, 4 malazezë, 2 maqedonas, 1 grek (minoritar) dhe 1 hebre. Viktimat kanë qenë nga Tirana 29 dhe 37 nga rrethet Fier, Korçë, Durrës, Shkodër, Vlorë e Dibër".

Kjo masakër ka mbetur në kujtesën e popullit si një nga ngjarjet më të egra çnjerëzore, një krim monstruoze që i rëndoi popullit tepër. Të tilla akte terrorizmi masiv praktikoheshin shpesh nëpër qytetet e Evropës në ato vite. Masakra e Tiranës, me aq pak banorë në atë kohë për makabritetin dhe numrin e të vrarëve dhe të arrestuarve nuk kishte precedentë. Raprezalja u krye papritmas nëpër të gjithë qytetin.

Nga pala shqiptare në krye të kësaj masakre ishin kuislingët Xhaferr Deva dhe Xhelal Staravecka. A ishte politike, apo ishte personale, siç japin versionin disa bashkëkohës, kjo duhet parë. Duhet thënë gjithashtu se, megjithëse kanë kaluar 80 vite, 4 Shkurti mbetet ende një ngjarje e pazbardhur, edhe për numrin e të vrarëve e të plagosurve, për emrat e viktimave që nuk janë evidentuar të gjithë, por edhe për vlerësimin e kësaj ngjarjeje. Çuditërisht, përveç emrit të një rruge në Tiranë, edhe ajo e ndërruar, pasi u zhvendos dhe u zëvendësua me një emër tjetër, nuk ka asnjë monument tjetër për të nderuar këto viktime dhe për të respektuar sakrificat e antifashistëve tiranas.

Përgatiti: Sakip Cami



## HISTORIA

Studjuesi Beqir Shehu vjen me një monografi interesante në 155 vjetorin e lindjes të patriotit kaladodas

# Qazim Lika, bashkëluftëtar i Ismail Qemalit, Hasan Prishtinës, Elez Isufit e Isa Boletinit

Nga Beqir SHEHU

Qazim Maliq Lika lindi më 1869 në fshatin Vasije të Kalasë së Dodës, në një familje të fisit Daku, ardhur nga Radomira. Qazimi ishte i dyti në radhë, i katër vëllezërve të mbetur jetim, me vdekjen e Maliqit, babait të tyre. Që në moshë të re, u detyrua të përballonte vështirësitë dhe problemet e familjes, që mbeti pa zot shtëpie. Në formimin e personalitetit të Qazim Likës, për t'u shquar dhe për të futur gjurin në sofrën e burrave, kanë ndikuar një varg ngjarjesh e zhvillimesh kohore.

Ai nuk qëndroi mënjandë ndaj tyre, por i përjetoi me një veprimtari të guximshme atdhetare, duke u vënë në drejtim të qëndresës popullore të një krahine me emër, siç ishte Kalaja e Dodës në fillimet e shekullit XX, vite kur ishin në lojë fatet e Shqipërisë.


Qazimi e kaloi fëmijërinë e rininë në fshatin e lindjes, Vasije, në atë mjedis natyror, ku njerëzit gëzojnë lirinë e fjalës dhe të veprimtari. Edhe pse nuk pati mundësi për t'u shkolluar dhe i rritur jetim, në sajë të kujdesit të nënës, Selvishahes, një nënëmadhe e vërtetë dhe djalit të hallës së tij, Haxhi Rexhep Lamallarit, i përmendur në Kala të Dodës për dije, kulturë e mirësi, Qazimi përthithi vetitë më karakteristike të mjedisit ku u rrit - besnikërinë, trimërinë, bujarinë, të cilat, ngjizur me mençurinë, krenarinë e vendosmërinë, që i kishte në gen, bënë t'i dëgjohej zëri jo vetëm në katund e në krahinë, por edhe në tryezat e diplomacisë së kohës.

Portretin fiziko-moral e kulturor, si dhe mpersonalitetin e veprimtarinë e tij, na i ka dhënë Tafil Boletini në librin "Pranë Isa Boletinit" (Kujtime), kur me shpurën e atdhetarit Isa Boletini, në nëntor të vitit 1912, po udhëtonte drejt Vlorës, qëndruan dy netë edhe në kullën e Qazim Likës. "Nga Ujmishi, -tregon Tafil Boletini: -Po me atë pari kemi dalë në Kala të Dodës. Bëmë konak te Qazim Lika, e njoftëm për burrë trim, fizikisht mjaft i zhvilluem, i zgjuet e gojëtar, por edhe në shpijë i rregullushëm, si me qenë qytetar!

Qazim Lika, si kryetar çete, i ka pas tronditur ato krahina, deri në fushën e Xhevxlhelisë. Veprimtaria e Qazim Likës, si luftëtar i paepur në luftrat për liri e pavarësi në çerekun e parë të shekullit 20-të, përveçse në këngë e në kujtimet e bashkëluftëtarëve, është pasqyruar edhe në shtypin e kohës, si edhe në letërkëmbimet e figurave më të shquara atdhetare shqiptare të kohës si, Ismail Qemali, Hasan Prishtina, Isa Boletini, Dervish Hima, Sotir Gjika, Nexhip Draga e shumë të tjerë, por edhe nga konsuj e deri kryetarë shtetesh, si konsulli Halla në Shkodër e ministri i Punëve të Jashtme të Austrisë, baroni Stefan Braun, kryeministri serb Nikolla Pashiq, etj.

Në këto dokumente dëshmohet se

• *Veprimtaria e Qazim Likës, si luftëtar i paepur në luftrat për liri e pavarësi në çerekun e parë të shekullit 20-të, përveçse në këngë e në kujtimet e bashkëluftëtarëve, është pasqyruar edhe në shtypin e kohës, si edhe në letërkëmbimet e figurave më të shquara atdhetare shqiptare të kohës si, Ismail Qemali, Hasan Prishtina, Isa Boletini, Dervish Hima, Sotir Gjika, Nexhip Draga e shumë të tjerë, por edhe nga konsuj e deri kryetarë shtetesh, si konsulli Halla në Shkodër e ministri i Punëve të Jashtme të Austrisë, baroni Stefan Braun, kryeministri serb Nikolla Pashiq, etj*



Qazim Lika, sëbashku me krerët më të njohur të krahinës së Kalasë së Dodës dhe të krahinave për qark Dibër, Lumës e Opojës, ishte organizatori dhe drejtuesi kryesor në Kuvendet e Dheut, ku u lidh besa e u hartuan planet e organizimit luftarak për përballimin, si të hordhive turke, të cilat kërkonin të reformonin e të mbanin gjallë germadhën turke në çerekun e parë të shekullit XX-të, kur shqiptarët kërkonin pavarësi, por edhe në mbrojtjen e trojeve kombëtare nga sulmet pushtuese të monarkive ballkanike e në veçanti, asaj serbe, që kërkonte me

çdo kusht daljen në Adriatik.

Qazim Lika udhëhoqi forcat e krahinës së Kalasë së Dodës në një varg betejash kundër forcave turke dhe atyre serbe si: Në vitin 1909, kundër forcave turke të Xhavit Pashës, duke e detyruar të vinte thembrat nga kishte vënë gishtërinjtë. Kundër taborëve të Turgut Pashës, më 1910, ku me gjithë qëndresën heroike të malësorëve, ishte e pamundur ndalimi i forcave të tij shkatërruese. Kundër hordhive të Kral Pjetrit, në betejën legjendë të Lumës në nëntor 1912 dhe veçanërisht, në kryengritjen antiserbe të shtatorit

## “KARTELA E DËSHMORIT ATDHETAR I VJETËR”

Shpallur dëshmor me vendim të Komitetit Ekzekutiv të rrethit Dibër, nr.72, date 23.5.1984, në të cilin shkruhet:

“Qazim Maliq Lika, datëlindja 1869, fshati Vasije i rrethit Dibër, në vitin 1913, në muajt shtator-tetor, sëbashku me udhëheqës të tjerë krahinash, komandoi forcat vullnetare kryengritëse kundër ushtrive pushtuese serbe në frontin e Dragashit. Gjatë operacionit serb të vitit 1913, ai iku në Selanik për të gjetur përkrahje, për të ndihmuar në luftën kundër serbëve. Në Selanik vdiq në burg i futur nga francezët (aleat të serbëve) në vitin 1914. Si udhëheqës i krahinës i luftrave kundër ushtrive pushtuese serbe, në frontin e Dragashit, gjatë muajt shtator 1913”

1913, ku Qazim Lika udhëhoqte edhe forcat e Gorës e të Opojës, ku edhe u plagos rëndë dhe u zëvendësua nga trimi i Gorës, Nail Hyseni, etj.

## Ja edhe disa nga dokumentet e kohës, ku pasqyrohet veprimtaria atdhetare e udhëheqësit popullor Qazim Maliq Lika

Letër e Hasan Prishtinës dërguar Dervish Himës dhe botuar në revistën "Arnaut" më 1910, që dilte në Stamboll. "Qazim Lika është një nga krerët më të shquar të Lumës dhe u ka rezistue tundimeve të Esat Pashës për ta bapër vete".

Ministri i Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, Baroni Stefan Burjan, i kërkon konsullit Halla në Shkodër intervencion për Qazim Likën.

"Bashkangjitur ju transmetoj një lutje të farefisit të një shqiptari, të quajturit Qazim Lika, referuar juve si referencë. Ju lutem që sëbashku me kthimin e lutjes, të raportoni këtu çfarë dini për Qazim Likën?" (Fondi i arkivit të Vjenës, Dosja, 26-9-1916).

Përgjigjja:

"Në konformitet me urdhërin e sipër shënuar dhe së bashku me kthimin e lutjes së nënës së Qazim Likës, të datës 15 shkurt të vitit në vazhdim, kam nderin t'u njoftoj Shkëlqesisë suaj, se Qazim Likën unë e kam njohur vitin e kaluar në Shkodër. Qazim Lika kishte lidhje miqësore me Hasan Prishtinën, të cilin ai e ndihmoi dhe me rastin e aksionit të tij, kundër serbëve

dhe kështu më kishte rekomanduar tepër prej tij. Ai ishte një nga krerët më të shquar të Lumës dhe u ka rezistuar tundi-meve të Esat Pashës, për ta bërë për vete. Arsyja e arrestimit të tij në Selanik, nuk dihet prej meje." (Shkodër 19 maj 1916. Nr.572 A.) Konsulli, p. dhe mb. Halla.

Dokumenti më me vlerë, ku pasqyrohet veprimtaria atdhetare e Qazim Likës si udhëheqës popullor në dhjetëra beteja kundër pashallarëve turq e pushtuesve serbë, por edhe si një burrë i mençur në kuvende dhe gjykues i ngjarjeve e njohës i zhvillimeve taktike e strategjike të betejave, ku kishte udhëhequr duke dhënë mendime shumë bindëse për shkaqet e humbjeve, apo të fitoreve të tyre, është intervista e gazetarit të gazetës "Shqypja e Shqypnis", Sotir Gjika në Athinë, më 21 janar 1911, botuar në këtë gazetë të Josif Bagerit, datë 26 shkurt 1911.2 Në letërnë përcjellëse të kësaj interviste, dërguar Josif Bagerit, nga Sotir Gjika, thuhet: "Këtu në këtë qytet, në Athinë, pata fatin e mire të ndeshem me zotni Qazim Lika, i cili asht një kryetar i gjindjes së Lumës, që nën kryetarinë e këtij kapedani, mori pjesë vitin që kaloi në luftrat e rrepta me byllikët e Turgut Pashës në Shqipërinë e Veriut. Qazim Lika më

## ESSE

*“Ne do të fitojmë sepse e kemi mbyll zemrën në kafaz për atdheun. Kauza jonë është e drejtë!”*

# LETRA E SKËNDER PEPIUT PËR PRINDËRIT

Neki ÇAKO



Skënder Mato Pepiu lindi në vitin 1923 në fshatin Progonat të zonës së Kurveleshit. Fëmijnë e kaloi së bashku me moshatarët e tij, aty në fshatin e tij të lindjes. Familja si gjithë të tjerët jetonte në skamje dhe varfëri të madhe. Ishte koha kur vëndi ishte nën sundimin e satrapit Zog. Djaloshi ëndërronte për një jetë më të mirë, por e kishte shumë të zorshme të kuptonte shkaku e vërtetë të mjerimit. Në afërsi të fshatit të Kaparielit ishte i vendosur Shtabi i Brigadës Pestë ASulmuese. Ishte dimër. Malet ishin mbushur me dëborë dhe ajo..., as që donte t'ja dinte, por vazhonte të binte me furi dhe më e dëndur. Ishte muaji shkurt. I ftohti kishte arritur kulmin. Mirëpo, Skënderi as që donte t'ja dinte për acarin. Ai shkoi drejt Kaparielit dhe me gjithë kushtet e vështira të natës, mundi të bashkohej me partizanët e brigadës së pestë. Me të mbritur aty Skënderin e shoqërojnë për në shtab të brigadës. Komandanti e pyet? Nga të kemi ty more djalë, që paske marrë rrugën i vetëm në këtë ditë dimri, ku të shqyejnë edhe egërsirat e jo më, të biesh në pritë të armikut. Nga Pro-

gonati jam shoku komandant! I njohim mirë këto shtigje. Sa herë kemi dalë me bagëti në këto anë dhe egërsirat nuk na kanë marrë dot asnjë cangadhe. Sa për armiqet, unë për të shporrur ata kam ardhur deri këtu, nëse do të më pranoni në brigadë. I kujt je ti mor djalë që na fletë kaq serbes, tha komandanti? I Matos,

Mato Pepiu. Dakort do t'ju pranojmë por me një kusht! Tani do të niseni për në fshat me një detyrë të rëndësishme. Skënderi fillimisht u frikësua se mendoi mos ishte ndonjë marifet për ta larguar nga brigada, por kur mori vesh vërtetë se ishte detyrë ai e pushtoi komandantin dhe u u qetësua. Së bashku me ju do të vijë edhe një shok tjetër partizan. Siurdhëron shoku komandant! Tani menjëherë u përgjigjen të dy si në kor me një gojë. Kur të mbritni ju në Progonat do të ketë kaluar gjysma e natës dhe ju do të zbuloni nëse ka gjermanë atje dhe do të merrni infomacione e do të ktheheni sërish këtu. Të dy së bashku sa hap e mbyll sytë u zhdukën në errësirë, në drejtim të Progonatit, për të realizuar misionin e ngarkuar. Skënderi së bashku me shokun e tij ai, nga Kuçi i Kurveleshit kaluan shtigje rrëpira udhë e pa udhë, që të mos diktoheshin nga forcat gjermane. Moti ishte në disfavor dhe nata bënte të vetën. Stuhia vazhonte. Misioni duhej realizuar. Të ecësh në ato shtigje është vështirë edhe ditën, por djemtë i njihnin mirë rrugët edhe pse në terr të natës. Dëborë nuk çahet, opingat prej lastiku ishin mbushur plot, por ata ecnin, nuk ndaleshin. Detyra duhej realizuar. Pasi kishte kaluar

mesnata ata mbrijnë në fshatin e tij të lindjes në Progonat. Partizani nga Kuçi qëndroi larg shtëpisë, ndërsa Skënderi po afrohej, duke u shmangur nga leha e qenve se mos diktohej nga armiku. Skënderi u afrua dhe kaloi nga gardhi mbrapa shtëpisë ju afrua dritares dhe trokiti lehtë në xham. Nuk dëgjohej asnjë lëvizje. Asnjë zhurmë veç erës së dimrit që vishkëllente dhe ja bënte të vështirë të dëgjonte reagimin nga ana tjetër. Tak..tak trokiti përsëri. Matanë xhamit u dëgjua një zë i lehtë. Kush është pyeti lehtë në Sherua? Jam unë nënë, Skënderi po hape dritaren. Bir i nënës dhe vetëtimthi hapi dritaren dhe i hodhi duart në qafë. Bir i nënës, po si erdhe në këtë natë terr e me llohë? Po ti vetë na ke mësuar dhe e pushtoi edhe ai me duar në qafë. Nënë, a ka gjermanë në fshat. Shëëë.. tha nënë Sherua! Fshati është plot me gjermanë. Edhe aty para shtëpise tek lëmi ka patrulla. A ka shumë dhe ku janë vendosur pyeti Skënderi, për tu siguruar. Në gjithë fshatin edhe në fshartat e tjerë janë shpërndarë kjo farë e keqe.. Mirë nënë por më jep pak bukë se do te iki prapë. Ku do shkosh tani natën, nuk e sheh se është terr dhe plot me gjermanë. Jo nënë, do iki se do përmbush misionin që kam marrë nga komandanti i brigadës pestë, por vurr dhe pak bukë se jam edhe me një shok me vete. Na duhet të ikim tani se ditën e kemi të pamundur lëvizjen. Pasi mori bukën që i ormisi e ëma, Skënderi para se të largohej i tha. Po iki nënë! Për ku e pyeti ajo? Për në Kaparjel. Na shkruaj bir i nënës, na dërgo fjalë dhe ashtu të përqaftuar në terrin e natës u ndanë! Një ditë marsi të vitit 1944, ditë dimri e ftohtë, partizanët kishin marrë kodrat përbmi Senicë. Po rrinin në pritje të marrjes së komandës për sulm. Urdhëri ishte i qartë dhe i prerë. Pas komandës duhet të merrnin kodrat dhe të sulmonin mbi gjermanët që ndodheshin në Delvinë. Skënderi krahas pushkës kishte edhe një murtajë të kalibrit të vogël. Komanda u dha dhe lufta u ndez furishëm. Skënderit i përfundoi municioni i murtajës dhe po qëllonte me pushkë. Një plumb e mori në kofshë. Shokët po i flisnin të largohet. Nuk është plagë e rëndë. Mirë, shko e ço murtajën i thanë shokët, që të tërhiqej. Skënderi i vendosur tha se nuk do t'ju lë vetëm, do luftoj deri në fishekun e fundit. Lufta vazhdoi e ashëpr. Ngelën rreth 14 partizanë të rrethuar. Forcat gjermane ishin të shumta në numër. Atëhere, Skënderi tha se duhet të çajmë rrethimin, të dalim nga këtu. Ju vazhdoni dhe unë do t'ju mbroj me zjarr. Bashkë me të ndenjën edhe nënë Fatua dhe partizani nga Kuçi. Rrethimi u çoi, shokët shpëtuan. Zjarri armik ishte i dëndur. Lufta vazhdoi deri në muzg, por Skënderi nuk u pa më. Të nesërmen batalioni sulmoi dhe armiku u largua në panik. Shokët e gjetën të pa jetë me pushkën në dorë. Në xhep i gjetën edhe një letër që do ta dërgonte në shtëpi. Në të shkruhej! Të dashur prindër. Jam shumë mirë. Ne do të fitojmë sepse e kemi mbyll zemrën në kafaz për atdheun. Kauza jonë është e drejtë! Atdheu është i shënjtë. Ju përqaftoj me mall, biri juaj Skënderi.!

## Ja edhe disa nga dokumentet e kohës, ku pasqyrohet veprimtaria atdhetare e udhëheqësit popullor Qazim Maliq Lika

(Vijon nga faqja 10)

priti vllaznisht dhe më kallëzoi mjaft çkoqitur e bukur për shumë punë. Ky zotëri ndër shumë të tjera fjalëve, që më tha, më ktheu kujtesën më shumë për këto luftra.” (Josif Bageri, gazeta, “Shqipja e Shqipnisë”, 26 shkurt 1911).

“Kur e pyeta këtë dashamirë se a mundet me u ngrit tanë Shqipënia”- shkruan gazetari Sotir Gjika. - Ky më tha se:- s'ka nevojë për me u ngrit tanë Shqipënia, po vetëm ata që rrokin hutat me luftue kundër armikut, të kenë vllazëri e bashkim..

-U thashë: - zotni, se mosbindja ndaj njani-tjetrit e pakryesia, na ka prish fort, e jo tjetër. Na jemi mjaft trima dhe vendi na ndihmon bukur për me ndenj kundra armikut. Sikur të më vinte një ndihmë vllaznore kur luftoja në qarkun e Lumës, besa - besë u thom or vlla, se nuk do ta lija Turgut Pashën ta shkelte Lumën dhe malësinë e Dibrës.”

“Po si munde me hy këtu në Greki, zotni Qazim Lika”? - e pyet gazetari.

“Zotni, munda me hy këtu në Greki me shumë mundime. Para dy javësh u ndesha në Pire me zotninë Qemal Begun (Ismail Qemalin), të cilin e luta me më dhënë pak men, se i hupa... Zotni Qemal Bej mu zotue se mbasi të mbërrinte shëndoshë e mirë në Stamboll, e pasi të merret vesh me zotnijtë: Myfit Begu (Mufit Libohova), Hasan bej Prishtinën dhe Nexhip bej Dragën, do t'më shkruajnë se qysh të baj; dhe kështu tani po pres letër prej Ismail Qemal begut këtu në Athinë, që t'më udhëzojë se si t'punoj e kur të shkojë”.

Gazeta “Besa Shqiptare”, shkruan: “...Më 1913, Qazim Lika ka shkëmbyer mendime me letra nëpërmjet ndërlihdësit Halil Shira, bashkëfshatari i tij nga Vasijet, me kryetarin e Qeverisë së Vlorës,- cituar në “Dibra dhe etnokultura e saj”, II, Tetovë 1996. Duke folur për kryengritjen e shtatorit 1913, konsulli austro-hungarez në Prizren, me telegramin nr. 28, datë 29.09.1913, njoftonte qeverinë e tij se: “Shqiptarët nën udhëheqjen e Qazim Likës, pas luftimeve të gjata, i kanë thyer serbët në Kolesjan, Vasije e deri afër Bicajt... e sot kanë arritur deri në Prizren... janë afërsisht 50 serbë të plagosur”. (Arkivi i

Vjenës në Institutin e Historisë”, Tiranë).

Disa vargje të një kënge për Qazim Likën në kryengritjen e vitit 1913.

(Këndohet në Vasije, në fshatin e tij).

“..Gjimon Dragashi e Pllaima/ kjo Nahija plot me trauma/Prizerenin kush e kalli/ Qazim Lika, bajraktari/ Qazim Lika e Beram Gjana/ bajnë hoxhum si dy asllana.”

Në Historinë e Shqipërisë, pjesa e tretë, 1977, f.430, shkruhet: “Kryengritja qysh në fillim përfshiu rrethin e Lumës. Kryengritësit e drejtuar nga Ramadan Zaskoci e Qazim Lika, e çliruan këtë krahinë dhe iu afruan Prizrenit. Kryengritësit u hodhën në sulm edhe drejt Gjakovës, por nuk mundën të hynë në qytet.”

Në fillim të vitit 1913, qeveria serbe e Pashiqit kishte nxjerrë në listat e zeza për likujdimin e prijësve Elez Isufin, Qazim Likën dhe Ramadan Zaskocin, duke paguar për kokat e tyre nga 1000 deri në 1200 dinarë. Në përgjigjen e Nikolla Pashiqit, dërguar majorit Leovac, datë 8 korrik 1913, thuhet: “Meqë këta njerëz janë të njohur edhe si kriminelë e hajdutë, ndaj tyre duhet vepruar sipas ligjit dhe nëse duhen para për eliminimin e tyre, këto të merren nga fondet ushtarake”

Duke u bazuar në citimet e mësipërme, mund të shprehim se: Qazim Lika, përveçse ishte një udhëheqës popullor e luftëtar trim, ishte njëherësh edhe burrë i mençur dhe një luftëtar i përkushtuar e vizionar për të ardhmen e Shqipërisë. Në këto dëshmi të padyshimta, bindemi se formimi patriotik i Qazim Likës, nuk i përket vetëm familjes e rrethit fisnor e krahinor të tij, por është edhe rezultat i ndikimit, që kanë pasur në formimin e personalitetit të tij, figurat me të shquara atdhetare shqiptare të kohës si: Ismail Qemali, Hasan Prishtina, Isa Buletini, Nexhip Draga, Dërvish Hima e shumë veprimtarë të tjerë të çështjes sonë kombëtare. Miqësia më këta burra mendjendritur, u lidh në mjedise kuvendesh dhe betejash, aty ku vendoseshin fatet e atdheut.

Përkushtimi i tij ishte vënia në shërbim të çështjes kombëtare, jo vetëm e pasurisë, por edhe e jetës e familjes së tij. Le të jetë ky portret, një lule në varrin e humbur të këtij luftëtari të paepur të çështjes tone kombëtare, që nuk kurseu as jetën për mbrojtjen e realizimin e saj.

## REÇENSA

# PANO HALLKO, libër për gjenezën e gjeopolitikës ballkanike

**Nga Shaban Murati**  
*"Mjeshtër i Madh" në diplomaci*

Libri i ri i studiuesit Pano Hallko "Ballkani viktimë e gjeopolitikës" mbush një vakuum të madh të ballkanistikës shqiptare. Ballkanistika shqiptare vuan nga mungesa e dy shtyllave të rëndësishme, që janë mungesa e këndvështrimit dhe e analizës gjeopolitike të historisë së Ballkanit, por edhe nga mungesa e sistemit të mendimit të ri diplomatik autokton shqiptar, në interpretimin e zhvillimeve historike dhe të marrëdhënieve të dy shteteve shqiptare dhe të kombit shqiptar, me shtetet e tjera të rajonit.

Gjeopolitika e sotme ballkanike nuk mund të kuptohet drejt pa hulumtuar thellë në gjenezën e saj. Është një mision i lodhshëm dhe i vështirë, prandaj në literaturën e sotme politike shqiptare mungon një studim i kësaj natyre. Pikërisht për këtë merr vlera studimi, që i paraqitet tani lexuesit dhe studiuesve të gjeopolitikës, të historisë, të diplomacisë, të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të politologjisë nga studiuesi i njohur Pano Hallko. Mund të thuhet se autori është ndoshta i pari në studimet shqiptare të gjeopolitikës ballkanike, që ndriçon karakterin dhe boshtin vertikal të kësaj gjeopolitike, një përbërës i domosdoshëm, pa të cilin nuk mund të gjesh çelësin e gjeopolitikës së sotme ballkanike.

Studimi i tanishëm ngërthen një kompleksitet dhe implikim të komplikuar të parametrevave të gjeopolitikës historike ballkanike, që ndriçojnë kuptimin e gjeopolitikës së sotme në gadishullin tonë. Kemi parashtrime të disa epokave historike, ku nisin rrënjët e karakterit dhe lidhjeve vertikale të kësaj gjeopolitike, nga e cila ka vuajtur aq shumë gjatë historisë kombi shqiptar.

Në pamjen e parë duket sikur autori hyn thellë dhe gjërisht nëpër shtigjet e historisë ballkanike dhe jashtëballkanike. Meritë e librit është se ai nuk bën histori dhe nuk është ky qëllimi i studimit të tij. Në çdo parashtrim të tij të fazave të ekzistencës, ngritjesh dhe rëniesh të perandorive, të përplasjeve dhe ndërhyrjeve të shteteve dhe fuqive të huaja, të pushtimeve dhe intrigave të tyre në rajon, kemi analizën e gjeopolitikës së tyre, të efekteve imedate dhe afatgjata që kanë në Ballkan. Në këtë sintezë thelbesh të lëvizjeve historike parakalon në libër një galeri e pasur konceptesh, doktrinash, teorish dhe programesh gjeopolitike, të konkretizuara nga aleancat e gjata ose të përkohshme, natyrale ose të habitshme, të shteteve, perandorive, fuqish të mëdha ose të mesme, figurash shtetërore, politike, diplomatike dhe gjeopolitike, të cilat i zbërthen lexuesit pikërisht në funksion të qëllimit të madh të studimit, që të hulumtojë në radhë të parë lidhjet

vertikale dhe horizontale historike të gjeopolitikës së sotme ballkanike, rajonale dhe jo rajonale, që ka diktuuar aq shumë rrugëtimin historik të kombit tonë.

Ndërthurja, që libri i bën gjeopolitikës ndërkombëtare dhe rajonale me fatet e kombit dhe shtetit shqiptar gjatë shekujve, ndihmon që të kuptohet se trashëgimia dhe bagazhi historik dhe diplomatik i gjeopolitikës së të kaluarës historike duhet të jetë bazamenti i çdo qeverie, diplomacie, dhe udhëheqësi të shteteve shqiptare në veçanti dhe të kombit shqiptar në përgjithësi.

Pozicionimi dhe këndvështrimi gjeopolitik shqiptar si busull orientuese për lidhjet dhe raportet e sotme shqiptare në çdo fazë të zhvillimit shoqëror, historik dhe poli-



tik ballkanik, i jep vlera studimit të Pano Hallkos në drejtim të pasurimit të teorisë shqiptare të marrëdhënieve rajonale dhe ndërkombëtare.

Pavarësisht se në çfarë fazash historike të analizuar në libër, të cilat ndërlidhen në funksion të ndriçimit të bazamentit historik të gjeopolitikës ballkanike, e vërteta historike është se gjeopolitika ballkanike ka ekzistuar si fenomen, si zhvillim dhe si rrymë drejtuese lëvizjesh historike, individuale apo grupore të shteteve të rajonit, shumë shekuj para se të dilte termi modern "gjeopolitikë".

Autori analizon dhe interpreton koncepte, teza dhe teori të shkencës së gjeopolitikës ballkanike, edhe për kohrat para se të lindëte si term dhe si shkencë. Ngjallin interes koncepte gjeopolitike si "zonat e ndërmjetme midis Lindjes dhe Perëndimit", Ballkani si "urë e lidhjeve midis shteteve apo kontinenteve", "përplasjet në Ballkan të qytetërimeve", e deri te koncepti i "ndërvartësisë së interesave të përhershme dhe të përkohshme", të cilat janë sot e kësaj dite në qendër të debateve për gjeopolitikën ballkanike.

E njëjta metodë e drejtë përdoret

nga autori edhe për luftën hibride si një nga instrumentat më të fuqishëm në gjeopolitikën e sotme rajonale. Edhe termi "luftë hibride" është i ri në literaturën moderne politike, por praktika e përdorimit të këtij instrumenti nga shtetet dhe diplomacitë në rajon, është i vjetër sa ekzistenca e shteteve, e fuqive dhe e perandorive. Vetë ambiciet e tyre të mëdha i shtynin tek nevoja e përhershme e përdorimit të formave dhe të mekanizmave sa më komplekse të realizimit të asaj gjeopolitike në Ballkan, që çonte tek realizimi i pushtimit apo i ndikimit. Si shtetet përdoruese të luftërave hibride, ashtu dhe shtete ballkanike pësuese të saj, nuk e dinin se ajo i ishte realisht luftë hibride gjeopolitike.

Në këtë prizëm të drejtë studimor,

libri ka qëmtuar dhe nxjerr në linjë e përshtatshmërisë së sotme gjeopolitike spektrin e gjerë të metodave dhe të formave konkrete të luftës hibride të ndjekur nga gjeopolitika ballkanike e fuqive të ndryshme gjatë shekujve. Në këtë kuadër zbërthenen intrigat politike dhe diplomatike, ndërhyrjet e nëndheshme shtetërore, diplomacia e kanonierave dhe diplomacia e fshehtë, diversionet dhe aleancat dypalëshe dhe shumëpalëshe, logjike apo alogjike, të shteteve ballkanike me fuqitë lindore dhe perëndimore, si dhe projektet specifike të zhvillimit rajonal, si mishërim i luftës hibride gjatë gjithë historisë ballkanike. Analizohet roli i një instrumenti të fuqishëm të gjeopolitikës ballkanike, kishës ortodokse në shtetet teokratike si Bizanti, Greqia, Serbia dhe Rusia, e deri tek lufta propagandistike me mediat e paguara rajonale dhe ndërkombëtare, siç është shembulli tepër domethënës historik dhe aktual i financimit nga qeveria greke e Lefter Venizellosit e disa mediave franceze, që në sajë të pagesave të majme greke profesonin dhe mbrojnë në Francë dhe në Europë ambici-



et dhe kërkesat shoviniste të Greqisë në Ballkan.

Duhet konsideruar pozitive që autori i është shmangur një prej defekteve kryesore të historiografisë shqiptare, e cila bart ngarkesa të mëdha ideologjike dhe partiake në interpretimin ngjarjeve, fazave dhe figurave historike. Për autorin rëndësia dhe prioriteti shkencor mbetet interesi i shtetit dhe i kombit, ndaj libri e konkretizon këtë vizion me mekanizmin e përthyerjes së gjeopolitikës aneksioniste të shteteve fqinjë ndaj Shqipërisë dhe kombit shqiptar.

Nëpërmjet ballafaqimit historik paraqitet ndikimi i aleancave politike shtetërore në Ballkan dhe në Europë, duke e ndihmuar lexuesin që të kuptojë aleancat e sotme dhe përzierjet e ekuilibrave të fuqisë dhe të ambicieve shtetërore, raportet dhe interesat e shteteve në skakierën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Duke u ndalur në evolucionin e idesë europiane apo të "Shteteve të Bashkuara të Europës", të propozuar nga Aristide Bryant në vitin 1934, autori bën lidhjet me konkretizimin e kësaj ideje europiane në ditët e sotme, në formën e BE. Me të drejtë jepet rëndësi faktit që edhe idea europiane nuk duhet idealizuar dhe duhet parë në lidhje të ngushtë me gjeopolitikën e fuqive të mëdha europiane. Historia dhe dinamika e zhvillimit organizativ shtetëror mbarëeuropian dhe qëndrimet e diplomacisë së BE dhe të shteteve drejtuese të saj në raportet ballkanike, kanë provuar se një vizion realist është i nevojshëm për të njohur ndikimin e idesë europiane në gjeopolitikën e sotme ballkanike.

Mund të mos jesh plotësisht dakord me disa nga idetë, tezat apo interpretimet e autorit të këtij studimi, por duhet thënë se me këndvështrimin e tij këmbëngulës, kërkues dhe me mënyrën interesante të analizës vertikale dhe horizontale të gjeopolitikës ballkanike, autori krijon kushtet për një debat të vërtetë në fushën e historiografisë dhe të diplomacisë si rrugë për tek e vërteta e kuptimit dhe e reagimit të mendimit politik dhe diplomatik shqiptar. Ky duhet konsideruar kontribut i vyer i librit, në një fushë të rëndësishme studimore, si dhe të praktikës shtetërore dhe diplomatike.

**(Marrë nga gazeta "DITA" me lejen e autorit)**

## PROFILE

# DY GRA DËSHMORE LABE TË PUSHKATUARA NGA FASHISTËT

(Homazh dhe mirënjohje me rastin e 80 vjetorit të ekzekutimit nga pushtuesit fashistë në fshatin Vajzë të Vlorës, të Këze Shahin Sulçaj (28.5.1898 – 25.12.1943) dhe Pesare Xhezo Kërroçaj (22.3.1906 – 30.1.1944), heroinave labe që u ekzekutua nga nazifashistët gjermanë gjatë LANÇ-it)

Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Gratë shqiptare përgjatë shekujve të mbijetesës nga pushtuesit kanë luftuar krah për krah burrave, kanë qenë burim frymëzimi për trimëri e mençuri nëpër breza. Ata kanë qenë nëna që kanë lindur trimërinë në djepe dhe kanë përkundur ëndërrat e lirisë së truallit arbëror. Gratë shqiptare që shkruan lavdi me gjakun e tyre janë të shumta në të gjitha betejat, por veçanërisht përgjatë LANÇ-it në rreshtat partizane u rreshtuan qindra gra e vajza në formacionet luftarake, pa llogaritur qindra mijëra të tjera që mbështetën luftën me ushqime, veshmbathje e transportim armësh e mundicione në drejtim të frontit. Historiku i fshatit Vajzë njih dy shembuj sinjifikativ të kontributit të dy grave heroina të këtij fshati në të cilin shkruhet respektivisht: “Këze Shahin Sulçaj, nëna e dëshmorëve Mete e Delo Mystehak Sulçaj, u vra nga nazistët gjermanë në afërsi të shtëpisë së saj më 28.12.1943. Ajo kujdesej shumë për partizanët dhe me çka i ndodhej i ushqente. Të dy djemtë e saj ishin në luftë në formacionet partizane. Ajo gjithçka e kishte vënë në shërbim të luftës (Këze Shahin Sulçaj, nëna e dëshmorëve Mete e Delo Mystehak Sulçaj, ishte me origjinë nga fshati Beçisht i Tepelenës; Historikut të fshatit Vajzë, 1981, f.141 dhe Historikut të vitit 2023, faqe 157); ndërsa rasti i dytë: “Pesare Xhezo Kërroçaj, ka qenë një grua fshatare e varfër, e cila me sa mundësi që kishte dhe me çfarë i ndodhej në shtëpinë e saj jepte kontributin e saj për luftën pa u kursyer. Gjermanët dhe bashkëpunëtorët e tyre e kapën Pesaren duke u larguar nga një kasolle dhe e pushkatuan me preteksin se ajo ndihmonte partizanët me ushqime, strehime etj”. (sipas Historikut të fshatit Vajzë, 1981, f. 143, dhe Historikut të vitit 2023, faqe 158).

Jeta dhe aktiviteti i të pushkatuarve të fshatit Vajzë është trajtuar në dekada si pjesë e krenarisë së fshati të martirizuar përgjatë luftës, fshat që për mbështetjen që i dha formacioneve çlirimtare ishte djegur tre herë nga fashizmi. Gratë e pushkatuara kishin tipare të përbashkëta të gruas qëndrestare dhe kundërshtuese të pushtimit.

Këze Shahin Sulçaj, që ishte edhe nëna e dëshmorëve Mete e Delo Mystehak Sulçaj, kishte lindur në Beçisht të Tepelenës më 28.5.1898, ndërsa Pesare Xhezo Kërroçaj ishte lindur në fshatin Vajzë të Vlorës më 22.3.1906. Vajzëria e tyre ishte një periudhë të pamundësisë për ta jetuar periudhën e fëmijërisë pasi fshatrat e tyre përngjanin për nga jetesa e vështirë ekonomike, megjithëse atyre nuk u trembej syri para asnjë vështirësie. Ato ishin rritur me halle dhe hallet nuk ju ndanë edhe kur u bënë nëna. Në Labëri thonë: “dardha bie nën dardhë”.

Oxhaku i familjar i kishte mëkuar që në vajzëri me dashurinë për atdheun



dhe urrejtjen ndaj pushtuesve. Të dyja ishin gra trimëshra, pasi nuk i mposhti as kërcënimet e fashistëve dhe as vdekja. Jetuan në familje të varfër, por krenare dhe me vlerat e larta njerëzore e atdhetare. Ato u bashkuan me gjithë gratë antifashiste të fshatit Vajzë dhe ndihmonin me luftën çlirimtare me gjithçka mundeshin. Ishte nëna e gra të zgjuara, të gojës, si dhe të patrembura nga vështirësitë e jetës, dhe i shikoje shpesh që të kuvendonin edhe me burrat e fshatit për problemet themelore dhe më të mprehta të fshatit në kohë pushtimi.

Pesarja është kapur nga fashistët dhe bashkëpunëtorët në janar 1944-ës pranë shtëpisë së saj dhe megjithë përpjekjet që bëri për t'u shpëtuar fashistëve dhe bashkëpunëtorëve të tyre, nuk i shpëtoi ndëshkimit fashist të breshërisë së plumbave. Kriminelët nazistë që erdhën në Shqipëri si “kalimtarë” të mbështetur edhe nga disa bashkëpunëtorë kishin mbritur edhe në zonat “problematike”, që rrebelimin ndaj pushtuesve e kishin në gjak. Që të dy gratë sikurse gjithë nënat në fshatin Vajzë, Këzja dhe Pesarja njiheshin si strehuese e forcave partizanëve dhe aktiviste tepër aktive për mbështetjen e Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Për qëndrimin e saj të vendosur pro LANÇ-it dhe duke mos mundur që ta detyronin të tregonte bazat partizane dhe mbështetësit e luftës partizane e pushkatuan në oborrin e shtëpisë në fshatin e saj në Vajzë të Vlorës. Akti i saj si dhe qëndrimi i palëkundur trimëror edhe përpara pushkatimit ishte një burim frymëzimi i një nëne heroinë për brezat, për atdhedashurinë dhe papërkulshmërinë edhe në situatat më kërcënuese për jetën edhe në momentet kur i morën jetën me vdekje skuadra naziste e pushkatimit. Breshëria e automatikut ja preu jetën në mes, në moshën 38 vjeçare,

Pesare Kërroçaj një nënë e fortë labe me vityte të larta atdhetarie në mesditën e 30 janarit 1944. Shembulli i saj u bë burim frymëzimi për gjithë vajzat e gratë e fshatit Vajzë dhe mbarë krahinës në mbështetje të Luftës së Madhe Antifashiste Nacionalçlirimtare. Push-



katimi i Pesare Kërroçaj me preteksin se ndihmonte partizanët dhe e kishte kthyer shtëpinë në bazë për mbështetje për partizanët, nuk i trembi dhe nuk i stepi bashkëfshataret e saj, nënat dhe vajzat e fshatit të Vajzës, që ishin bërë mbështetje e fuqishme për luftën antifashiste në fshat dhe në mbarë krahinën.

Fakt është se në gati gjysëmshkulli Pesare Xhezo Kërroçaj është trajtuar si dëshmore edhe pse nuk i ishte akorduar titulli me vendim juridik, kur në fakt e kishte merituar prej kohësh. Në radhët e librit të ish Zëvendësministrit të Mbrojtjes Popullore, ushtarakut madhor Maliq Sadushi, “Fshati ynë i mirë, Histori e fshatit Vajzë”, (Shtëpia botuese, “Arbri”, Tiranë, 2002,) në faqen 271-272 ka një gjykim e sugjerim si amanet brezash: “Okupatori nazifashist në bashkëpunim me tradhtarët, në çdo operacion që ndërmori bëri terror në popull. Ata kapën e pushkatonin gra e fëmijë të pafajshëm. Krime të tilla bënë edhe në Vajzë duke kapur e pushkatuar pa gjyq nëntë vetë, midis tyre edhe dy gra. Po të merret parasysh aktiviteti i këtyre viktimave në dobi të luftës dhe mënyra se si janë kapur nga armiku, qëndresa e tyre etj, ata me të drejtë duhen quajtur dëshmorë të LANÇ-it dhe jo viktimat. Ky problem mbetet i hapur edhe në organet kompetente dhe mund e duhet të shikohen në të ardhmen... ligjërisht ky problem nuk zgjidhur ende”. Por populli ynë ka një maksimë proverbiale që thotë se, “e drejta zhytet por nuk mbytet”.

Këze Sulçaj dhe Pesare Kërroçaj ranë nga breshëria e plumbave të fallangave fashiste. Ato ranë në fushën e nderit për të mos u harruar dhe për të mos vdekur. Ato ngelën në kujtimet e fshatit Vajzë, të krahinës, ndërkohë që kryeplaku dhe pleqësia e fshatit Vajzë e ka evidencuar si një ndër dëshmorët që plotëson kriteret ligjore, bazuar në ligjin nr. 109/2018, datë 20.12.2018, “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, në nenin 5, “Kriteret për shpalljen e statusit “Dëshmor i atdheut”, Pika “d” në të cilën thuhet që: shpallen Dëshmorë të Atdheut “shtetasit shqiptarë të pushkatuar për pjesëmarrjen në forma-

cionet luftarake të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare apo për mbështetje të pjesëmarrësve të Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar, si dhe të pushkatuar për hakmarrje nga pushtuesit nazifashistë apo bashkëpunëtorët e tyre, nga data 7 prill 1939 deri më 9 maj 1945”. Është mëse e natyrshme se ligji ka hapur dritën jeshile që Këze Sulçaj dhe Pesare Kërroçaj, të shpallen me titullin “Dëshmor i Atdheut” bazuar në kriteret ligjore. Propozimi për herë të parë për ti shpallur dëshmore është bërë në vitin 1989 - 1990, por me kalimin në sistemin e ri demokratik, dokumentacioni ngeli i paplotësuar në ish-Komitetin Ekzekutiv të Këshillit popullor të rrethit të Vlorës. Prishja e sistemit e shtyu procesin e përgatitjes së dokumentacionit në pothuaj mbi një çerek shekulli.

Gratë dhe vajzat në fshatin Vajzë, në Labëri dhe në të gjithë Shqipërinë, u afirmuan si luftëtare të lirisë dhe progresit shoqëror e politik me aktivitetin dhe shembullin e tyre, edhe në zonat më të thella të vendit. Ashtu si bashkëluftëtarët e tyre në formacionet partizane, ato i rezistuan faktorëve të rrezikut në luftë, i rezistuan vështirësive të terrenit natyror e të motit, i rezistuan urisë dhe pagjumësisë, i rezistuan torturave e plagëve të marra në luftë, u përballën me burgjet fashiste dhe kampet e përqendrimit e të shfarosjes në masë, u përballën me dhimbjen e ndarjes nga jeta të njerëzve të tyre të afërt dhe luftëtarëve të çetave, batalioneve e brigadave partizane. Shembulli më sinjifikativ janë edhe ekzekutimi i dy grave të ekzekutuar nga fashistët në fshatin Vajzë të Këze Sulçaj dhe Pesare Kërroçaj.

Shembulli i kontributit të këtyre grave, luftëtare të lirisë, dëshmore e heroina duhet të njihet, respektohet dhe të mbrohet nga brezat, si modeli luftarak i qëndresës për ekzistencën e mëvetësinë e shtetit dhe kombit. Krahas akteve të larta të trimërisë dhe të vetëmohimit të shumë grave e vajzave si, Bule Naipi, Persefoni Kokëdhima, Liri Gero, Margarita Tutulani, Shejnaze Juka, Mine Peza, Nimete Progonati, Zonja Çure, Qeriba Derri, Fato Berberi, Qybra Sokoli, Ylbere Belibashi, Shenjnaze Juka, etj., kishte edhe gra që u ekzekutuan si mbështetëse të fuqishme të kësaj lufte të madhe të shqiptarëve.

Gratë e fshatit Vajzë dhe të mbarë Labërisë sikurse gratë në mbarë shqiptarinë në Luftën Nacionalçlirimtare, ishin kontribuuese reale të çlirimit kombëtar e shoqëror të saj. Lufta ishte në njëjtën kohë edhe një shkollë e madhe për emancipimin shpirtëror të gruas, ku në fakt grua shqiptare theu mjaft koncepte e praktika të vjetra dhe afirmoi veten e saj të denjë për një shoqëri të lirë dhe përparimtare.

Gjaku i grave të fshatit Vajzë, i Këzes dhe Pesares ishte gjaku që u derdh për lirinë e Shqipërisë dhe kombit shqiptar, prandaj edhe meriton vlerësim, nderim dhe mirënjohje në ditët tona dhe në brezat që do të vijnë.

## SUPLEMENTI LETRAT

# FIGURA MADHORE E ALI PASHË TEPELENËS NË STUDIMET E AKADEMIKUT IRAKLI KOÇOLLARI



## SHPENDI TOPOLLAJ

Në historinë e Shqipërisë të pas Skënderbeut, figura e Ali Pashë Tepelenës, të mbiquajtur "Luani i Janinës", mund të themi pa asnjë dyshim, se ka qenë më e përfolura dhe e shoqëruar me vlerësime të autorëve vendas e të huaj, por edhe nga çka na ka mbërritur nga trashëgimia jonë gojore, nga më kontradiktoret. Sido që të jetë, qofshin ata që e kanë parë atë me anët e tij të mira, si trim, të mençur, largpamës, burrështetas autoritar, që duke udhëhequr me dorë të hekurit pashallëkun e tij, i bëri karshillëk edhe vetë Portës së Madhe, apo dhe ata që kanë parë tek ai, sundimtarin e egër mizor, gjakatar, dinak e hakmarrës, nga i cili dridhej edhe foshnja në bark të nënës, në një pikë kanë qenë në një mendje: se nuk mund të kuptohet historia jonë, pa veprën e tij, të shtrirë në një periudhë prej rreth tre dekada e gjysmë. Pikërisht për hir të këtyre cilësive që vështirë të ndërthuren te një njeri i vetëm, ai ka tërhequr interesin e politikanëve, diplomatëve, strategëve, shkrimtarëve dhe historianëve të ndryshëm. Dhe gjithmonë, librat për të, janë përpërë nga lexuesit e të gjitha kategorive. Por, ai që nuk u lodh duke hulumtuar, duke shkruar e duke botuar për të është Profesor doktori i respektuar Irakli Koçollari. Duke hedhur vështrimin qysh nga viti 1998 kur nisën botimet e librave të tij për tepelenasin emërmadh, që arritën kulmin me dyvolumshin "Policia Sekrete e Ali Pashës" dhe tre volumet me korrespondencën dhe dorëshkrimet e tij, e deri te ky që na bijnë tani në dorë me plot 800 faqe, botim dinjitoz i ONUFRIT, mund të themi se puna dhe këmbëngulja e tij do të qe e denjë edhe për vetë Irakliun e mitologjisë, i cili për t'u ngjitur në Olimp përmesh heroikisht, plot 12 stërmundime. Koha kur Aliu jetoj dhe sundoi ishte e ngarkuar me ngjarje nga më të çuditshmet që shpesh merrnin kthesa të papritura dhe që përherë përfundonin me vrasje të pabesa që shkonin deri në kasaphanë. Por ishte edhe koha për të cilën britaniku Bagalli apo amerikanë Koliopulos konkludonin se shqiptarët u bënë "djepi që përkundi këtë lëvizje që shërbeu si pararendëse e lëvizjeve të armatosura për pavarësinë e Ballkanit".

Përpara se të mbërrijë tek "Alipashaida" e Haxhi Shehretit, pra tek ajo që me të drejtë do të konsiderohej jo vetëm "Iliada" shqiptare, por edhe pararendësja e poezisë shqipe, autori ka preferuar ta përgatisë lexuesin si me studimet dhe analizat e tij të mençura, ashtu edhe me plot mendime të shfaqura nga personalitete tërësisht të besueshme dhe me autoritet, jo thjeshtë për kualitetet që kishin, pra për reputacionin e tyre, por edhe si njerëz që e kishin njohur nga afër atë. Por është e natyrshme që ai t'i kushtojë një vëmendje të veçantë autorit të vetë poemës dhe ta paraqesë atë jo vetëm me një kulturë superiore dhe besnik të Aliut, por si jetëshkruesin më autentik, për të mos thënë edhe kronologjik, pasi i shërbeu atij për 60 vite me radhë, tashmë në vargje, të atyre ngjarjeve dhe bëmave të tij që e bënë të pavdekshëm. Haxhi Shehreti ishte diplomati që përfaqësoi dhe mbronte interesat e Aliut në oborin e Sulltanit. Ai kishte lidhje dhe gëzonte miqësinë e shumë njerëzve të shquar, si p.sh. Elkhini i famshëm dhe fjala e tij dëgjohej me shumë respekt.


Mjaft të shohësh informacionet dhe propozimet që ai i bënte Ali Pashës, dhe do të bindesh se ai ishte nga më konfidentët e tij. Sa sundoi, Aliu i dha rëndësi të madhe arsimit, dhe për këtë dëshmon ajo

që na kumton Fred Dagllasi që thotë (perifrazoj) se ai për arsimin dhe mësimin e gjuhës ka pikëpamjet e tij gjithëpërfshirëse dhe të thella, duke sugjeruar një institucion të madh (universitet), nën kujdesin e Psalidhës, më të diturin e Greqisë të cilin sipas Panajoti Avrantinoit e porosiste që ta mësonte siç duhet rininë dhe t'u jepte shembuj të mirë se do të kishte tërë përkrahjen e tij. Dhe shton: "Këtu çdo gjuhë moderne ka mësuesin e saj. Pastërtia e diksionit, përhapja e mësimdhënies dhe e njohurive mbi botën që ndryshojnë shoqërinë e tij, e bëjnë Janinën, Athinën e Greqisë moderne". Dhe nuk është për t'u çuditur kur lexojmë historianin britanik Finlay i cili tregon se "Fëmijët e shqiptarëve myslimanë, mund t'i shohësh në të njëjtën parrahomë duke lexuar Kuranin me një osmanllë të shkolluar, ndërkohë që në dhomën tjetër një djalosh kristian i së njëjtës moshë mund ta shikosh duke mësuar shkrim greqisht me një prift grek".

Ja pse në Janinë veç teologjisë, mësohej edhe fizika, kimia, matematika dhe arsimit ishte i lirë, i pavarur dhe krijues. Në të tillë klimë është e kuptueshme, përse Ali Pasha, zgjidhte për t'i mbajtur pranë në punët e shtetit, njerëz si Haxhi Shehreti. Dhe në apollojinë që Irakliu i bën talentit të këtij poeti, me mjaft finesë e gjithmonë me argumente, brenda të cilave ka një llogjikë të paqortueshme, ka ditur të debattojë apo kundërshtojë ndonjë qëndrim dyshues si ai i konsullit sympretë Martin Eilliam Leake që e quan pararendës të albanologjisë, i cili teksa aludonte për anën artistike të kësaj vepre, prej nga duhet të ketë marrë materialin kryesor për librin e tij "Biografia e Ali Pashës", shprehet se "poezia e krijuar në një vend të prapambetur tenton të bjerë në prozaizëm". Po kështu, u është përgjigjur ai, atyre historianëve grekë dashakeqës që kanë synuar

cilësive të tij të rralla. Prandaj, të gjitha lavdërimet që Shehreti formulon për të, janë mëse të merituar dhe në të gjithë shtrirjen e poemës, nuk ka vend të mendosh për egzagjerime, simpatira personale apo ditirambe nga ato të Arionit e Pindarit (shek. VII - V p.e.r.). Shkollë nuk kishte as Genghis Khani, i mbi 800 viteve më parë, por çdo vit shkojnë e falen mongolët tek ajo statuja e tij 40 metra e lartë, në Tsonjin - Boldog në breg të lumit Tola, pranë Ulanbaturit.

Kurse ne, si para qederosemi për t'i bërë homazhe Ali Pashait tonë të cilin Bajroni e quante "kapedan të pavarur, figura e tretë historike pas Aleksandrit të Madh dhe Skënderbeut", tek ajo statuja e tij në Tepelenë edhe pse ai për vite me radhë iu kundërvu hapur Sulltanit, duke synuar pavarësinë, çka del qartë edhe te letra që i dërgon Shehretit në Prill të 1813, ku i thotë troç se "... nëse nuk më do Sulltani që të jem i gjallë në këtë dynja, le të bëhet ç'të dojë, unë do t'ia dal...". Dhe ashtu u bë, gjersa në 24 Janar të 1822 në pabesi, pas një viti e gjysmë rezistence ndaj 50.000 ushtarëve armiq dhe i braktisur, iu pre koka, duke mbetur njëri nga shqiptarët e vetëm me dy varre, një në Kastros të Janinës e tjetri në Stamboll të Porta e Silirvisë. U nda më dysh, ai për të cilin Aleksandër Duma flet me aq admirim, dhe i madhi Viktor Hygo thosh: "Ali Pasha rri përballë Bonapartit, si tigr i luanin, ata ngjajnë me njëri - tjetrin si dy pika uji, sepse të dy e filluan karrierën nga hiçi dhe u ngjiten deri në majat e perandorëve". Në librin e tij, Irakliu na tregon se janë të paktën tri poema kushtuar Aliut, por ndërsa njëra që konfirmohet nga Aravantinos, nuk gjendet, tjetra e artikulluar nga shqiptari plak emigrant në Greqi, Jani Paguni dhe sjellë nga Emile Legrandi dhe që quhet "Vaje për Ali për Pashën", në dialektin epirot, mbetet anonime.



t'ia ulin rëndësinë dhe vërtetësinë veprës madhore të "myslimanit" delvinjot Haxhi Shehreti.

Këtyre të fundit, ai u kujton konstatimin objektiv e të guximshëm të Aristidh Koljas që shkruante: "Imagjinoni si do të konsiderohej në letërsinë greke Shehreti nëse ai do të ishte i krishterë dhe do të lëvdonte betejat e suljotëve kundër Ali Pashës. Një poemë në 10.000 vargje e shkruar në vitin 1800 do të mbetej origjinale, unike dhe pa një të dytë në llojin e saj". Koçollari nga ana e tij i ka bërë poemës së Shehretit jo një përkthim, por shqipërim sa korrekt aq edhe artistik. Si e tillë, të duket se më mirë në gjuhën tonë nuk do ta kishte shkruar as vetë autori i saj i dy shekujve më parë. E ndarë në kapituj sipas ngjarjeve, ai ka ditur të ruajë si metrikën, ku kam parasysh strukturën dymbëdhjetë rrokëshe të vargut, rimën e puthur oksitone, figuracionin e tingëllimin muzikal, ashtu dhe atmosferën e kohës. Ja si na parqitet vetë Pashai në madhësinë e tij: "Të gëzuar gjithë njerëzia anë e mbanë në vilajete / Vijnë përulen Ali Pashës, plot para nëpër sepete. / Ditë pas ditë Ali Pashës famën, zulmet ku s'ia gjen / Emri i tij njihet dynjasë nga India në Jemen, / Dhe në shtatë Ishujt e Jonit i dëgjohej soji, fara / Dhe askush në ato anë nuk guxon t'i dalë përpara". Dhe duhet pranuar se nuk ishte as prejardhja nga gjyshi dizdar i Tepelenës, as nga i ati pasha që u vra kur ai qe ende i vogël, as se e ëma Esmiha Hanëmi vinte nga Zenelbenjllitë e Konicës apo se ajo pasi u rrëmbye me të bijën nga Kardhiqotët kur kishte shkuar të mblidhte taksat, dhe u keqtrajtua prej tyre, i la amanet atij që të hakmerrej, shkaqet që ai arriti aq lart. Duke ditur se ai nuk ishte as i shkolluar si duhet, llogjika ta do të thuash se Ali Pasha u bë ai që njohu Evropa mbarë, së pari, falë

E megjithatë, ai arsyetonte se edhe ajo, në të gjithë treguesit është vazhdim i veprës së Haxhi Shehretit. Ma do mendja se kështu do të mendojë kushdo lexues kur t'i ballafaqojë ato. Pavarësisht kësaj, autori i këtij libri impresionues duhet falenderuar edhe për këmbënguljen e ndjekjes së rrugëtimit të këtyre krijimtarive kaq të rëndësishme letrare të asaj kohe plot trazira. Me jetën e ndershme dhe mbylljen e saj në varfëri, duke u ndalur vetëm te shembulli i kërkesës së llogarisë ndaj argjendarit Haçaturian për zbulimin e armëve të Pashait me diamante, figura e Haxhi Shehretit mbetet një shembull i vyer për të gjithë ne sot, që përfetojmë korrupsionin që shkatërron shtetin. Po ashtu, të shkruarit si një intelektual i shquar atdhetar, nga ana e akademikut Irakli Koçollari jep edhe shembullin që duhet ndjekur nga politikanët tanë, të cilët pa asnjë detyrim e kanë dorëzuar te të huajt sovranitetin dhe dinjitetin e Shqipërisë tonë, asaj Shqipërie për popullin e të cilit miku i Bajronit, John Hobhouse shkruante se: "Tek i gjithë ky popull ekziston një shpirt indipendence dhe dashurie për vendin e tyre... Kështu, kur pyet banorët e provincave të tjera se çfarë është ai, ata do të përgjigjen "unë jam mysliman" ose "unë jam kristian". Ndërsa po të pyesësh një banor të këtij vendi (Shqipërisë), se çfarë është ai, ai do të përgjigjet - "Unë jam shqiptar". Në përfundim, nuk mund të mos theksoj se Prof. dr. Irakliu me këtë vepër ka vërtetuar më së miri fjalët e francezit Alphonse de Lamartine i cili thosh për të parët tanë: "Ata kanë një shpirt poetik, ashtu sikurse edhe zakonet e tyre. Këngët popullore... të kujtojnë këngët homerike shumë më mirë se sa këngët e plogështa të Greqisë moderne. Ato pleksin, sikurse Akili, poezinë, vallen me luftën...". E mbaron së lexuari këtë libër dhe ai tingëllimi i atij vajtim për vdekjen e Ali Pashës, të ndjek pas. I rënë duke luftuar, ai të kujton Imam Aliun që i vrrarë së bashku me të birin, Hasanin, nga Muavija i Sirisë në 661, së bashku me Perëndinë dhe Profetin Muhamet, konsiderohet trinia e shenjtë e bektashinjve. Kështu e pati quajtur Ali Pashanë tonë edhe Bajroni. I tillë del ai edhe në tërë krijimet letrare - historike të Prof. dr. Irakli Koçollari, me gjithë virtytet dhe veset që impononte ajo kohë e trazuar.

## SUPLEMENTI LETRAT

17 janar 2024, në 556 vjetorin e vdekjes së SKËNDERBEUT

## POEMA "ROMANCA E SKËNDERBEUT"

Shkruar nga David Herman Bernstein  
Botuar nga Gazeta "ORA" Tiranë 1932

Ambasadori Mal BERISHA: Në përvjetorin e 556 – të i vdekjes së Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, do të desha që të sjell përpara jush një akt të rrallë, të pa shoq, të papërsëritur, të jashtëzakonshëm, të mrekullueshëm: Poemën e të birit të Ambasadorit Amerikan Herman Bernstein, Davidit, me titull:

**"ROMANCA E SKËNDERBEUT".**

Herman Bernstein vetë shërbeu në vendin tonë në kohën e Mbretërisë nga vitit 1930 – 1933. Ky intelektual i jashtëzakonshëm me gjak hebraik dhe shtetësi amerikane, ka lënë një trashëgimi të jashtëzakonshme, diçka që askush tjetër nuk e ka bërë pas tij. Ambasadori Herman Bernstein e edukoi të birin, Davidin, me dashurinë dhe respektin e madh për Kombin Shqiptar dhe Heroin tonë Kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu. I tillë ishte edukimi i Ambasadorit Amerikan ndaj të birit, sa ai, Davidi, shkroi një poemë për Skënderbeun, në gjuhën angleze, në vitin 1932, të cilën po e postoj me fragmente në këtë datë të shënuar për kombin tonë. Poema përbëhet nga 303 vargje dhe është e ndarë në disa pjesëza. Ajo fillon me:

**AGIMI – 1443**

"Kujt po vraponin, po vraponin nëpër natë.  
Zhurmë e bujshme – katërqind thundra –  
Q'ushtonin thellë në të malit air të freskët.  
Dyqind Shqiptarë që vraponin për liri!

I kishte dorëzuar Turqit në duar të Hungarezëve;  
Trathti kjo? Jo! Një virtyt për lirin e një race?  
Qysh Skënderbeu dhe çeta e patriotëve Shqiptarë,  
E kishin kapur qatipin e Sulltanit,  
E kishin shtërnguar të nënshkruajë një shkresë lirie.  
Dhe pastaj e kishin vrarë –

Se të gjithë kjo janë pjesë të njerëzimit.  
Kujt po vraponin nëpër natë.  
N'errësirën e thellë, vetëm turma të zeza fluturonin,  
Befas, e për çudi, cepi i Hënës  
E tregoj buzën e tij si më trup,  
Përmbi majën e një kodre lindore;  
Më parë një rrebesh, pastaj një shi i ergjëntë,  
Mbuloj malet e errët me pyjet më t'errët.  
Degët me fletë e drithëruan dhe pëshpëritnë qetësisht  
Për shkak t'asaj ndërprerje të natës ëndërrore.  
Tatëpjetë e përpjetë, kaluan shtratet e lumenjëve  
dhe të përrenjëve që mërmërisnin.

**DREKË - HERË - 1444**

Shkoni përpara, shkoni përpara, ju o trima –  
Shqipëria është e lirë, dhe provën e dha.  
Kto male, kta lumënj janë t'onët.  
I liriua fëmijët, t'ona,  
Rifitua shtëpitë t'ona  
T'onët janë pyet, gjithë t'onë;  
T'onët janë brigjet, gjithë t'onë,  
Të gjithë gëzojnë lirinë e Shkabës,  
Të lirë duhet të jemi për gjithnjë,  
Të lirë nga i huaji dhe nga armiku,  
Të lirë nga Sulltani i Osmanlli,  
Vetëm Njërit i falemi  
I falemi Zotit përmbi ne,  
I falemi Atij, që na liroj,  
I përulemi Atij, që nënqesh mbi ne.

Parpara pra!  
Dhe Skënderbeu, prijës i Shqipërisë,  
Ngau përpara me gjithë ushtarët e tij,  
Ngau nga Kruja, nga Kështjell e tij,  
Nga Kruja vënd i stërgjyshërve të tij.

Së bashku me qindra Shqiptarë,  
Që u bënë shokë në diçka, më në fund,  
Dhe Skënderbeu, Mbreti i Shqipërisë,  
U gati të kthehet në Krujë,  
Bashkë me burrat e tij të shumtë  
I ngarkuar me lavdi dhe me robër,  
Dhe u kthye në Krujë q'ish tash e lirë,  
Pasi e hodhi tej zgjedhën e skllavërinë.  
Dhe fitoj të drejtën e vet Lirinë,  
U-kthyen prapë nga Dibra  
Burra trimat që luftuan për atdhe!

Se Skënderbeu, Mbreti Shqiptar,  
Vdiq midis bashkëatdhetarëve,  
Vdiq n'Atdheun e tij, në Shqipëri,



## Zbulimi, si e njohin Skënderbeun në SHBA! Flet studiuesi Halit Daci!

**E**missioni Shqip nga Rudina Xhunga në Dri-tare TV iu kushtua figurës së Skënderbeut, në 556-vjetorin e vdekjes së heroit tonë kombëtar. Halit Daci nga SHBA, një studiues që i ka kushtuar kohë në studimet e tij figurës së Skënderbeut, tregoi se si heroi ynë kombëtar, është i njohur në mbarë botën, jo vetëm për cilësitë e tij si një luftëtar i jashtëzakonshëm, por edhe një karakter që ka ngjallur mjaft interes për publikun, skenën, poetët dhe piktorët.

"Studimin për Skënderbeun e kam nisur në vitin 2007 kur studioja letërsinë angleze. Madje edhe mbrojtjen e masterit në The City University of New York, e kam bërë me temën për Skënderbeun. Pasi e përfundova e botova në vitin 2009 në Shqipëri, por në gjuhën angleze. Ka një numër të konsiderueshëm të veprave letrare për Skënderbeun në gjuhën italiane, spanjolle, portugeze dhe gjermane.

Librat e mi, janë vetëm për letërsinë angleze dhe janë botuar në SHBA dhe Britani.

Në vitin 1896 është shkruar një dramë për Skënderbeun nga një autor i njohur në SHBA, William Eaton. Ka qenë një gazetar në Çikago dhe biznesmen. Librin e ka adoptuar bazuar në një novelë të autorit britanik Benjamin Disraeli që quhet The Rise of Iskander. Kjo

dramë ka marrë vetëm një incident nga ky libër.

Pas një viti përgatitjesh kjo dramë është vënë në skenë nga dramaturgu aktori tragjik Frederick Warde. Gjatë kësaj kohe, në karrierën e tij teatrale ka bërë mjaft drama shekspiriane në skenë, dhe mes tyre edhe drama romantike.

Kjo është një nga dramat që është thuhet e panjohur për publikun shqiptar, por edhe për lexuesit dhe studiuesit. Kjo dramë është luajtur në 8 shtete të SHBA. Për herë të parë është shfaqur në 14 tetor 1897 dhe është luajtur për 3 muaj deri më 15 janar 1898. Ka patur një jehonë të madhe historia e Skënderbeut në SHBA sepse Skënderbeu nuk ka qenë vetëm një hero dhe luftëtar i famshëm, por edhe një karakter mjaft i dashur për publikun, skenën, poetët dhe piktorët. Ka qenë një dramë shumë suksesshme. E mirëpritur mjaft mirë nga publiku.

Po kështu një film për Skënderbeun një prodhim shqiptaro-rus, është shfaqur në Amerikë për rreth 12 vjet në shumë shtete. Shumë nga dramat që janë vënë në skenë, janë në arkiva, pra janë të vdekur. Ndaj për ta bërë historinë e Skënderbeut më të njohur, duhet bërë më shumë. Kjo u është lënë në dorë studiuesve që e bëjnë personalisht, por puna nuk është e organizuar", u shpreh zoti Daci.

Dhe ishte varrosur në qytetin e Lezhës.  
Shkoj aty, dhe bashkë me vendin e tij,  
Që nuk mund'te më t'u bëntë ballë shkelësve.

**PERËNDIM – 1468**

As edhe për të mbrojtur heroin e tij të vdekur,  
Skënderbeu, Mbreti i Shqipërisë, u çvarros prej Turqve,  
Dhe eshtrat e tij u shpunë jashtë vendit të tij...  
Kur më e fundmja kockë e tij kaloi kufirin,  
Çdo shpresë në Shqipëri u-zbe dhe vdiq.  
Se mbretëria malsore humbi bashkë me prijësin e saj,  
Dhe u-bë krahinë e Turqisë, Turke me gjithsej,  
Përveç pupullit që vajtonte humbjen dhe rrinte i hutuar,  
Me një të fshame, fort të dhimbsur,  
Plot trishtim dhe mungëse besimi.

Dhe ujërat nga triumfi të tërbuara,  
Kërcenin në valë të harbuara,  
Njëdash vetëm një buzë kishte mbetur,

Nga lëmshi njëherë zotnues,  
Një buzë e pështjellë q'u mbulua  
Prej një reje e shpejtë e stresuar  
Dielli ngjyrë çeliku të murmë, perëndoi.

Njëqint valë të vogla rrethuan vëndin ku u krodh,  
Njëqint valë të vogla që shikonin një jetë,  
Gjersa një valë e madhe, e shkumbëzuar nga egërsimi,  
I mbajti gjallë valët e vogla dhe u-dërmua në zall.  
FUND

**Shënim:** Këtë poemë e ka botuar Gazeta ORA në numrat e saj nr. 18, 21, 23, 25, 28, 30 të muajt qershor 1932.

Emri i përkthyesit nuk është i shënuar në gazetë.  
Falenderim: Falenderoj botuesin e njohur Mehmet Gëzhilli pronari i Shtëpisë Botuese "ARGETA LMG" i cili më dhuroi këtë material kaq kuptimplotë për atë që ka bërë Ambasadori Amerikan Herman Bernstein.

Ky material gjendet ne website:  
<https://malberisha.com/17-janar-2024-sot-ne-556-vjetorin.../>

## AKTUALITET

# Inaugurohet Njësia Ushtarake e Sigurisë Kibernetike

**E**diel, 14 janar 2024 Njësia Ushtarake e Sigurisë Kibernetike, një strukturë e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura është tashmë funksionale edhe me mbështetjen e aleatit strategjik të Shqipërisë, SHBA.

Kryeministri Edi Rama, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i ngarkuari me punë në Ambasadën e SHBA në Tiranë, David Eisner si dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor Arben Kingji morën pjesë në inaugurimin e kësaj njësie që do të luajë një rol kyç në luftën kundër kërcënimeve kibernetike dhe mbrojtjes së sistemeve tona të informacionit.

Ata u njohën nga afër me strukturën dhe funksionin e kësaj njësie, që ka si qëllim menaxhimin e sistemeve të sigurisë kibernetike që mbikëqyrin dhe monitorojnë: Sistemet e Komunikimit dhe Informacionit të Forcave të Armatosura nga ndërhyrjet e paautorizuara në këto sisteme.

Pranë kësaj njësie do të jetë i atashuar edhe një këshilltar i huaj, i cili do të mbështesë këtë strukturë për 3 vjet për sigurinë kibernetike.

Në këtë njësi përdoret teknologjia më e fundit, ashtu si edhe në SHBA, ndaj sipas ekspertëve nuk ka patur asnjë rrjedhje informacioni të Ministrisë së Mbrojtjes.

Në fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi u shpreh se synimet janë që kjo njësi të shërbejë edhe si një



shkollë për të trajnuar ekspertët, jo vetëm për fushën e mbrojtjes, por edhe agjencitë e tjera dhe pse jo edhe tregun privat: "Jo vetëm projekti që është shumë i plotë, por ne kemi mundësinë e madhe që në rrjetin e qendrave të inovacionit të mbrojtjes kibernetike të NATO-s të marrim informacione të vazhdueshme, të kemi trajnime. Ka një qendër të NATO-s në Estoni, ku ne jemi pjesë e saj. Mundësitë janë shumë të mëdha. Është arritur brenda një kohe të shkurtër një standard mbrojtjeje shumë i lartë. Janë shumë

të motivuar, janë 50% ushtarakë, 50% civilë. Duam t'a shtojmë akoma më tej këtë strukturë, t'a përdorim si shkollë për të trajnuar ekspertë që mund t'i shërbejnë jo vetëm Forcave të Armatosura, por edhe sektorit privat, sepse në fund të fundit kjo rrit kapacitetet mbrojtëse kombëtare", - u shpreh ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi.

Aktualisht, sipas ekspertëve ka çdo ditë 1500 deri në 2 mijë sulme, por asnjë prej tyre nuk është konsideruar kritik.

Në njësinë Ushtarake të Sigurisë Kibernetike, e cila përbëhet nga tre sektorë të veçantë punohet pa ndërprerje (24/7).



## UDHËTIM I SUKSESSHËM NË JETË, I NJËRIT NGA "DJEMTË E E GEGHYSENIT" - "NDERI I KOMBIT"



Luigj Gurakuqi".

Detyrat e fundit në ushtri që ka kryer Aliu është ajo e Komandantit të Regjimentit të Mbrojtjes Territoriale për qytetin e Shkodrës, regjiment i kompletuar me forca rezerviste. Në këtë detyrë qëndroi dy vjet nga viti 1995-1997. Ishte në detyrë dhe shkatërrimin e ushtrisë me 12 mars 1997 e ka përjetuar si dhimbjen më të madhe në jetën e tij.

Me rivendosjen e gradave në ushtri në vitin 1991, Aliu mori gradën Nënkolonel, të cilën e ruajti deri me daljen në reformë në vitin 1998-të. Në vitin 2000 ka dalë në pension të plotë, duke lënë emër të mirë, si oficer i karrierës i shpallur disa herë shembullor.

### KUR STËRVISTE LUFTËRARËT E UÇK-SË

Pas daljes në reformë, kur në vitin 1998-1999, zhvilloheshin luftime për çlirimin e Kosovës, ka kontribuar, për dërgimin e shumë djemëve të rinj kosovar (të ardhur në Shkodër), në frontin e luftës, në Papaj të Tropojës, përballë Koshares së Kosovës, ku për këtë kishte rënë në dakort me Sali Çekaj (tashmë hero i luftës së Kosovës) i rënë në betejën përfundimtare për thyerjen e kufirit në Koshare. Është

për tu theksuar se dy vllazerit oficera të Nënkolonel Ali Denushit, për kontributin që kanë dhënë për çlirimin e Kosovës, ku njëri prej tyre është plagosur nga forcat serbe gjatë luftimeve, janë shpallur nga Qeveria e Kosovës "Veteranë të Luftës së Kosovës".

Aliu ndër të tjera kujton Luftën çlirimtare të Kosovës në vitet 1998-1999, ku kishte parë në zonën e Tropojës djem të Kosovës që vinin nga anët e botës, që nga Amerika për të luftuar për Kosovën dhe kishte prej atyre që nuk kishin as njohuritë elementare në njohjen e përdorimit të armëve e municioneve, që vetëm me një përgatitje të shkurtër prej tre-katër orësh nga kuadrot oficer të Brigadës së Tropojës, hynin direkt në fushën e luftës kundër forcave serbe të Millosheviçit në rajonin kufitar të Koshares, e padyshim për mungesë përgatitjeje kanë patur dëmtime, "Ah! Sikur keta djem të kishin përgatitjen ushtarake të nxënësve e studenteve tanë, humbjet do të ishin më të pakta", shprehet ai.

### VEPRIMTAR SHOQËROR SHEMBULLOR

Ali Demushi, edhe pas daljes në pension vazhdon të kontribuojë në interes të komunitetit e çështjes kombëtare, si brenda vendit dhe në trojet tjerashqiptare, Gjakovë, Deçan, Prishtinë, Plavë e Guci etj.

Në tri konferenca është zgjedhur Kryetar i Organizatës së Bashkuar të Veterave (OBVL) Dega Shkodër, të cilën e ka drejtuar mjaft mirë. Po kështu është anëtar i Kryesisë së Shoqatës "Drini" Shkodër - Gjakovë, ku ka kontribuar për sensibilizimin e idesë për ndërtimin e rruges automobilistike të bregut të Drinit, Adriatik Alpe, në bashkëpunim me Shoqatën "Drini" Gjakovë - Shkodër. Krahas veprimtarisë jetësore Aliu studion e shkruan periodikisht në shtypin e kohës, veçanërisht në gazetën "Veterani", organ i OBVL-së. Një aspekt i rëndësishëm në jetën e Aliut është fakti se ky i mbështetur nga prindërit shumëarsimdashës, ka treguar kujdes e ka dhënë kontribut prindërorë e vllazrorë për shkollimin e fëmijëve, vllazërve e motrave të tij, ku të gjithë sot kanë krijuar familjet e tyre, punojnë e jetojnë normalisht.

Njëherësh Aliu është i dalluar për marrëdhëniet e mira me komunitetin për pesë dekada në qytetin e Shkodrës. Por dihet gjithashtu se Ai e ka pikë të dobët, vendlindjen, Malësinë e Gjakovës (Tropojë) e veçanërisht Geghyzenin "Nderi i Kombit", ndaj dhe pothuasje në çdo dy muaj shkon atje, takon të afërm, shokë e miq me të cilët rrin e kuvendon, u bën vizita për raste të ndryshme gëzimi e ngushëllimi, në shenjë respekti, nderimi e detyrimi si traditë e përhershme e Tropojës.

(Vijon nga faqja 8)

Gjithashtu Aliu me Urdhër të Ministrisë së Mbrojtjes është emruar Komandant i Regjimentit të Rinisë Shkollore e Studentore të Armatosur për qytetin e Shkodrës, për një periudhë katër vjeçare 1987-1991. Kjo strukturë e mbrojtjes u trajtua me të njëjtat kërkesa si ato të njësive tjera ushtarake. Në organiken e regjimentit, bënë pjesë repartet që formoheshin me nxënësit e 10-të shkollave të mesme dhe dhe studentët të Institutit të lartë Pedagogjik "Luigj Gurakuqi", sot "Universiteti